



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 89/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.02.2020, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin shoqërisë “Devis” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr. REF-44572-11-22-2019, me objekt: “*Sherbimi i Lavanterise dhe Hotelerise ne Spitalin Rajonal Fier*”, me fond limit 162 155 700 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 06.01.2020, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Fier.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e BOE “Alfa Cleaning” sh.p.k & “Kombi Invest” sh.p.k në procedurën e prokurimit.

Ankimues: “Devis” sh.p.k
Nj.B 8, Rr. “S.Kodra”, Mgazina 10, Kat1, ZK 8330, NP 1/1136 Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Spitali Rajonal Fier.
Lagja “1 Maj” Rruga “Invalidet e Luftes”, Fier

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.11.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr. REF-44572-11-22-2019, me objekt: “*Sherbimi i Lavanterise dhe Hotelerise ne Spitalin Rajonal Fier*”, me fond limit 162.155.700 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 06.01.2020, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Fier.

II.2. Në datën 17.01.2020 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

- | | |
|-------------------------------|--------------------------------|
| 1. “Devis” sh.p.k | 141.307.110 lekë, skualifikuar |
| 2. “Kombi Invest” sh.p.k | 156.132.774 lekë, skualifikuar |
| 3. “Sanitary Cleaning” sh.p.k | 159.839.190 lekë, skualifikuar |

Operatori ekonomik “Devis” sh.p.k rezulton i skualifikuar pasi:

“*Operatori ekonomik nuk ka paraqitur certifikaten e pronësise se automjeteve ose kontraten e shitblerjes ose kontrate dhurimi ose cdo dokument tjetër me të cilën fitohet e drejta e pronësise sipas Kodit Civil.*”

II.3. Në datën 22.01.2020, operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

"Shoqeria Devis shpk, me date 06.01.2020 ka paraqitur oferten duke ofruar cmim ekonomik mjaft te favorshem dhe te gjithë dokumentacionin e kerkuar nga AK per proceduren e prokurimit " Sherbimit i Lavanterise dhe Hotelerise per Spitalin Rajonal Fier" Publikimi: Buletini i Njoftimeve Publike REF-44572-11-22-2019.

Me date 17.01.2020 nepermjet sistemit te prokurimit publik u njoftuam per rezultatet e vleresimit nga KVO si me poshte:

<i>Operatoret ekonomike</i>	<i>Vlera e ofertuar</i>	<i>Refuzuar</i>
<i>DEVIS shpk</i>	<i>141,307,110</i>	<i>Po</i>
<i>KOMBI INVEST</i>	<i>156,132,774</i>	<i>Po</i>
<i>SANITARY CLEANING</i>	<i>159,839,190</i>	<i>Po</i>

Po ne te njejten date jane njoftuar dhe arsyet e s'kualifikimit te ofertes sone dhe konkretisht KVO shprehet se: operatori nuk ka paraqitur certifikaten e pronesise se automjeteve ose kontraten e shitblerjes ose kontrate dhurimi ose cdo dokument tjetër me te cilin fitohet e drejta e pronesise sipas kodit civil.

Shkakun e mesiperme te s'kualifikimit tone e kundërshtojme si me poshte vijon;

Ne dokumentat standarde te tenderit, kriteret per kualifikim, kapaciteti teknik pika 3.3.4 eshte percaktuar: Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 2 (dy) mjete transporti mallrash, me kapacitet transportues minimalisht 500 kg, me qëllim transportin e mallit, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës, si më poshtë:

a) Dokument që vërteton pronësinë ose qiramarrjen si më poshtë:

➤ Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Ose

➤ Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje (noteriale)..

b) Leje qarkullimi e mjetit.

c) Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,

d) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,

e) Certifikate për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg).

Shoqeria jone ka paraqitur dokumentacion per mjetet e kerkuara; Lejen e qarkullimit, Siguracion, Certifikaien e kontrollit teknik, gjithashtu keto mjete jane te pasqyruara ne bilancet e shoqerise si dhe ne ekstraktin e rregjistrimit ne QKB, pra eshte vertetuar qe keto mjete jane ne pronesi te shoqerise DEVIS shpk.

Qellimi i vendosjes se kriterit eshte qe nepermjet dokumentacionit te paraqitur operatori ekonomik te vertetoje se disponon mjetet e kerkuara te nevojshme per realizimin e kesaj kontrate. Eshte mese e qarte me dokumentacionin e paraqitur eshte plotesuar kriteri i percaktuar. Per autoritetin kontraktor eshte e rendesishme te provohet qe operatori ekonomik zoteron kapacitetet teknike ne lidhje me mjetet e transportit, ne perputhje dhe ne perpjesetim me natyren dhe volumin e kontrates objekt prokurimi, kapacitet i cili eshte vertetuar se disponohet nga operatori ekonomik "DEVIS" sh.p.k. Konkretisht ka paraqitur dokumentacion disponon ne pronesi tre mjete nga dy te kerkuara te vertetuara me Lejen e qarkullimit, Siguracion, Certifikaten e kontrollit teknik ku eshte percaktuar pronesia e tyre DEVIS sh.p,k, per tre mjete transporti duke e tejkaluar sasine e kerkuar, gjithashtu keto mjete jane te pasqyruara ne bilancet e shoqerise si dhe ne ekstraktin e rregjistrimit ne QKB, duke krijuar bindshem garanci per realizimin me sukses te kontrates.

Vendimi i KVO-se eshte absolutisht i padrejte dhe i bazuar ne pretendime hipotetike dhe jo ne fakte qe ekzistojne i cili na skualifikon pa asnje arsye, ne kundershtrim te hapur me rregullat e prokurimit publik. Kompania DEVIS ka plotesuar ne menyre te perpikte te gjitha dokumentat tekniko-ligjore, sipas te gjitha kerkesave te pergjithshme dhe te vecanta te kualifikimit te kerkuara nga AK. Te ndodhur ne keto kushte ne sqarojme se me kete kuotim jo vetem qe po behet nje padrejtesi e hapur ndaj subjektit tone, por nga ana tjeter po i shkaktohet nje dem ekonomik relativisht i madh buxhetit te shtetit.

Cdo AK dhe cdo anetar i KVO, nese do te kishte vemendjen per te pare dokumentat e gjendura ne SPE te operatorit DEVIS sh.p.k dhe pikerisht ne QKB (bashkelidhur ketij materiali), sheh ne pronesi te rregjistruara te gjitha automjetet qe disponon kompania dhe konkretisht 3 prej te cilave ishin depozituar ne sistemin e prokurimeve elektronike.

- 1. Automjeti me targe AA8910H*
- 2. Automjeti me targe AA076PN*
- 3. Automjeti me targe TR 3620U*

Ne ligjin Nr.8378, date 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikes se Shqiperise", i ndryshuar, nenin, 92 pika parashikohet:

Pjesa III Dokumentat e qarkullimit dhe regjistrimit

Neni 92 Formalitetet e nevojshme per qarkullimin e automjeteve, te motomjeteve dhe rimorkiove
1. Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot per te qarkulluar duhet te jene te pajisura me nje leje qarkullimi dhe te jene te regjistruara prane degeve perkatese te Drejtorise se Pergjithshme te Sherbimeve te Transportit Rrugor. 2. Deget e Drejtorise se Pergjithshme te Sherbimeve te Transportit Rrugor marrin masa per regjistrimin dhe leshojne lejen e qarkullimit ndaj atij qe verteton se eshte pronar i mjetit, duke treguar, kur duhet, edhe gjeneralitetet e shfrytezuesit ose te qiramarresit me te drejte blerjeje ose te shitesit me marreveshje me te drejte rikthimi, kur nuk paguhen kestet, sic eshte treguar ne nenin 90.

Pra si mund te pretendohet qe mjeti qe ka leje qarkullimi eshte mjet pa pronesi kur pronesia eshte e shprehur ne QKB por jo vetem, por edhe ne bilancet e dorezuar ne SPE ku pronesia e tyre sic edhe ju do ta shqyrtoni eshte ne emrin e DEVIS shpk,

Ne kontrollin teknik te mjetit eshte shkruar qarte targa e makines dhe qe leshohet leja e qarkullimit pikerisht sepse mjeti ka pronesi.

Ligji nr. 10 076, date 12.2.2009 per sigurimin e detyrueshem ne sektorin e transportit, ndryshuar me ligji nr. 10455, date 21.7.2011, Neni 4, Detyrimi per t'u siguruar

1. Pronari i cdo mjete transporti, perpara perdorimit te mjetit, eshte i detyruar te lidhe nje kontrate sigurimi, sipas pikes 1 te nenit 2 te ketij ligji, si dhe te siguroje rinovimin e saj per aq kohe sa mjete i transportit do te mbetet ne qarkullim.

2. Kur mjete i transportit eshte subjekt i detyrimit per t'u regjistruar apo licencuar dhe, sipas ligjit, duhet te kete nje certifikate regjistrimi apo licencimi, autoritetet pergjegjese mund ta leshojne certifikaten e regjistrimit ose ndonje dokument tjeter, te barasvlershem me te, vetem pasi pronari i mjetit te transportit provon me dokumente se e ka lidhur kontraten e sigurimit, sipas ketij ligji.

Pra si mund te kishte mjete siguracionin pa pronesi?

Edhe ne dokumentin e siguracionit ka nje ze te vecante ku shkruhet pronesia e mjetit si dhe NIPTI i shoqerise, elemente qe nuk lene vend per dyshime apo me shume akoma .

Ne nenin 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 4, te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, percaktohet se:

4. Autoriteti kontraktor vlereson nje oferte te vlefshme edhe nese ajo permban devijime te vogla, te argumentuara, te cilat nuk ndryshojne thelbesisht karakteristikat, kushtet dhe kerkesat e tjera, te percaktuara ne dokumentat e tenderit, si edhe gabime shtypi, te cilat mund te korrigojohen paprekur permbajtjen e saj.

Shoqeria "Devis" sh.p.k me dokumentacionin e paraqitur verteton dukshem se disponon ne pronesi automjetet e kerkuara nga autoriteti kontraktordhe si e tille duhet kualifikuar.

Persa me siper shkaku i s'kualifikimit tone nuk qendron, shpresojme ne reagimin e menjehershem nga ana juaj, ne te kundert, shoqeria DEVIS shpk do te ndjeke te gjitha shkallet e ankimimit ne institucionet e parashikuara nga ligji,

Bashkelidhur gjeni:

1. Ekstraktin e historikut leshuar nga QKB i shoqerise DEVIS sh.p.k,
2. certifikatat e pronesise se automjeteve
3. Lejet e qarkullimit te mjeteve.
4. Certifikatat e kontrollit teknik te mjeteve rrugore,
5. Policet per sigurimin e detyrueshem te mjeteve,

II.3.1. NËpërmjet shkresës nr. 355 prot., datë 27.01.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit duke e refuzuar ankesën si më poshtë:

"[...] Autoriteti Kontraktor, pasi analizoi me kujdes pretendimet e ankimuesit te parashtruara ne ankese, dokumentat bashkengjitur ankeses, pasi u konsultua me dispozitat e Ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar, te V.K.M. nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar, te legjislacionit ne fuqi qe rregullojne fushen objekt ankimi, bazuar ne teresine e dokumentacionit te dosjes se tenderit, ne format elektronik dhe aktet e dosjes, ne kerkesat per kualifikim te DST, arsyeton si me poshte vijon:

Se pari, nga verifikimi ne sistemin elektronik te prokurimeve, por edhe ne dosjen e tenderit, konstatohet se ne oferten elektronike te paraqitur nga subjekti ofertues DEVIS shpk, per

kete tender, mungon dokumentacioni perkates per plotesimin e kriterit per kualifikim te percaktuar ne shkronjen "a", e pikes 3.3.4, te shtojces 8, Kriteret e vecanta te kualifikimit, te DST. Pra, mungon fizikisht Certifikata e pronesise e leshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose Kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose cdo dokument tjetër me ane te te cilit fitohet e drejta e pronesise sipas Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

Bazuar tek ky fakt, jemi perpara kushteve qe ofertes se subjektit ofertues ne kete gare DEVIS shpk, i mungon dokumentacion per nje nga kriteret per kualifikim te percaktuara ne DST. Pra, subjekti ofertues ne kete gare DEVIS shpk nuk ka dorezuar nje dokument te percaktuar shprehimisht ne kerkesat per kualifikim te DST.

Ne paragrafin e fundit te Shtojces 8, Kerkesat per Kualifikim, te DST, sanksionohet shprehimisht se: „Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.”

Ne nenin 46, pika 1, te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomike, per te marre pjese ne procedural e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevoishme, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohen dhe jodiskriminuese."

Gjithashtu ne nenin 53, pika 3 te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet se: "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentat e tenderit ...".

Autoriteti Kontraktor, ne analizen dhe shqyrtimin qe i ben ankeses dhe pretendimeve te parashtruara ne ate, bazohet totalisht ne dispozitat e sipercituara ligjore, ne rregullat e prokurimit, ne kriteret apo kushtet e percaktuara ne DST, si dhe ne qendrimet ligjore dhe te konsoliduara qe ka mbajtur Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), ne trajtimin qe kjo e fundit i ka bere ceshtjeve te ngjashme, ku jane shtjelluar dhe argumentuar analiza dhe vendimmarrja, qe ajo i ka bere pretendimeve te ngjashme, te paraqitura nga ankimues te ndryshem [...].

Mosplotesimi qofte edhe i nje kriteri te vendosur nga ana e autoritetit kontraktor, e ben oferten e operatorit ekonomik te pavlefshme, si dhe perben kusht per skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit, pra nga gara, sic percaktohet ne paragrafin e fundit te Shtojces 8, te DST.

Per kete arsye, LPP dhe rregullat e prokurimit, nuk mund te lejojne kualifikimin e nje operatori ekonomik ne rast se ai ka mungese dokumentacioni sipas kritereteve percaktuara nga vete autoriteti kontraktor.

Keto qendrimet te ligjit dhe te rregullave te prokurimit, sa i takon trajtimin te kesaj ceshtje, kane rendesine e tyre te madhe per zhvillimin e nje procedure konkurruese prokurimi, pasi ato jane garante te zhvillimit te nje gare te barabarte mes paleve (neni 2 i LPP-se).

Qendrimet ndryshe nga cfare percaktojne Ligji dhe rregullat e prokurimit per kete pike, do te cenonin sigurine juridike te paleve pjesmarrese ne gare dhe do te legjitimonin diskriminimin midis garuesve. Cfare do te ndodhte nese cdo subjekt ofertues, nuk dorezonte ne sistemin elektronik te prokurimeve, dokumentat e kerkuara teper qarte ne DST dhe pastaj nepermjet ankimimit kerkon qe keto dokumenta ti dorezoje nepermjet ankeses, per te bere oferten nga

te pavlefshme ne te vlefshme? Atehere, gara e zhvilluar ne oren dhe daten e caktuar ne sistemin elektronik te prokurimeve nuk do te kishte sens dhe do te humbiste kuptimin e saj.

Pikerisht kjo eshte edhe arsyeja pse ligjvenesi nepermjet dispozitave te meiperme ligjore apo rregullave te prokurimit, ka garantuar cdo ofertues duke i dhene sigurine juridike te duhur, qe gara zhvillohet vetem ne oren dhe daten e caktuar per dorezimin dhe hapjen e ofertave, dhe jo pas saj. Pas mbarimit te ketij afati asnje pjesmarres ne gare nuk kate drejte per asnje lloj arsyeje apo justifikimi te fus dokumenta ne oferten e tij per ta kthyer ate nga te pavlefshme ne te vlefshme (fjalja e dyte e pikes 1 te nenit 53 te LPP-se).

Nga shqyrtimi dhe nga analiza e kesaj ankese, ne fakt, nga subjekti ankimues kerkohet ne thelb pikerisht kjo gje. Ne ankese pranohet edhe nga vet subjekti ankimues qe ky dokument mungon, pasi nuk eshte ne listen e dokumentave te dorezuar ne sistem per plotesimin e ketij kriteri (sic jane leja e qarkullimit, etj.). Gjithashtu, fakti i mungeses se ketij dokumenti verifikohet nga keqyrja ne SPE e ofertes se paraqitur nga ky subjekt. Por, megjithate nga subjekti ankimues kerkohet nepermjet ankeses, qe ky dokument te merret ne konsiderate, duke ia bashkengjitur ankeses.

Autoriteti Kontraktor sqaron se ne rast se operatori ekonomik ankimues do te kishte pretendime ne lidhje me kerkesen e mesiperme te autoritetit kontraktor, ka pasur ne dispozicion momentin procedural te paraqitjes se ankeses mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve te vecanta te kualifikimit te procedures se prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP ose momentin procedural te paraqitjes se kerkeses per sqarime prane autoritetit kontraktor deri ne pese dite para dorezimit te ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-se.

Nga verifikimi i dosjes se tenderit nuk rezulton te kete pasur kerkese ankimore apo kerkese per sqarime ne lidhje me shkronjen "a", te pikes 3.3.4, te shtojces 8, Kriteret e vecanta te kualifikimit, te DST, se kesaj procedure prokurimi. Ne keto kushte, subjekti ankimues, si cdo subjekt tjeter ofertues qe ka qene i interesuar per te marr pjese ne kete gare, duke gene se e ka pranuar kete kusht apo kriter kualifikimi ka qene i detyruar te dorezoje ne sistemin elektronik te ketij tenderi, dokumentacionin sipas shkronjes "a", te pikes 3.3.4, te shtojces 8, Kriteret e vecanta te kualifikimit, te DST. Per me teper qe, ky kriter kualifikues qendron si pike me vete ne Shtojcen 8 te DST (shkronja "a", e pikes 3.3.4), i pasuar nga kriteret e tjera te kualifikimi, te renditura ne shkronjat: ,b', ,c', d' ,e', te pikes 3.3.4.

Rrjedhimisht, per sa me siper, pretendimi i subjektit ankimues nuk qendron, pasi nuk gjen mbeshetje ne ligjin nr.9643 date 20 .11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar [...].

Ne ankesen e tij, subjekti ankimues parashtron se ne dokumentin ekstrakt i QKB te DEVIS shpk, te gjendura ne SPE, jane te shenuara te gjitha automjetet qe disponon kompania, duke cituar 3 (tre) prej tyre, dokumentacioni i se cilave eshte depozituar ne sistemin e prokurimeve elektronike (pervec certifikates se pronesise).

Nga verifikimi i dokumentacionit te subjektit DEVIS shpk, te depozituar ne tender, konstatohet se ne ekstraktin e QKB-se (te thjeshte e historik), ne piken 13 te tij "vende te tjera te ushtrimit te aktivitetit", rezultojne te cituara adresat dytesore te ushtrimit te aktivitetit Tirane, markat e mjeteve dhe targat e tyre. Ne kuptimin e ligjit per QKB, te Kodit Civil, te Kodit Rrugor apo cdo akti tjeter ligjor dhe nenligjor, shenimet e adresave dytesore te ushtrimit te aktivitetit te nje subjekti, nuk perbejne detyrimisht fakt apo tregues se ato jane ne pronesi te subjektit, sepse ato

mund te jene te marra me qera apo ne huapendorje apo ne formate tjera qe njej ligji. Ne praktike, sic mund te konstatohet lehtesisht ne ekstraktin e QKB te shume subjekteve, ne piken 13 te tij "vende te tjera te ushtrimit te aktivitetit", vendosen adresat dytesore (NIPT sekondare) te ushtrimit te veprimtarise se subjektit, te cilat mund te jene mjete, por mund te jene edhe zyra, godina, kapanone, prone e paluajtshem ne pergjithesi, etj., ne pronesi te subjektit, por edhe te marra me qira apo huapendorje.

Kete pohim e vertetojne edhe seksionet perkatese ne ekstraktin historik, ku evidentohen hapjet e adresave dytesore, dhe ku konkretisht thuhet p.sh: "eshte shtuar adresa Tirane, Tirane Fiat Doblo me large AA 891OH" pa specifikuar nese eshte ne pronesi apo eshte marr me qira.

Pra, eshte e qarte, se gjithsesi, thjesht fakti qe mjetet jane te cituara ne ekstraktin e QKB, nuk perbejne argument ligjor qe mjetet jane ne pronesi. Jo me kot, dhe me te drejte AK ne Shtojcen 8 te DST, ka kerkuar, certifikaten e pronensise se mjetit, si dokumentin e vetem dhe ligjor i cili tregon dhe verteton pronesine e nje mjeti ne Republiken e Shqiperise ose kontraten e qirase, ne rast se mjetet do te ishin marre me qira.

Per kete arsye, bazuar ne parimin e analogjise juridike, sjellim ne vemendje edhe faktin se kjo eshte arsyeja pse ne rastet e shit-blerjes se nje automjeti te regjistruar rregullisht ne Republiken e Shqiperise, noteri per te kryer aktin e kalimit te pronensise (kontraten e shitblerjes), nuk kerkon as ekstraktin e QKB, as lejen e qarkullimit, as bilancin e subjektit dhe as siguracionin e mjetit, por kerkon paraqitjen e certifikates se pronensise se mjetit. Ky fakt eshte nje tregues dhe prove teper domethenese juridike, qe tregon rendesine e ketij dokumenti dhe arsyet ligjore per te cilat AK me te drejte e ka kerkuar ne DST, se bashku me dokumentat e tjera te mjetit, te cilat kane efekt dokumentues per rregullshmerine e levizjes (qarkullimit) te mjetit ne rruge dhe jo per pronesine e tij.

Kerkesat e AK te percaktuara ne DT jane ne perputhje me dispozitat e Kodit Rrugor, duke kerkuar te gjitha dokumentacionin ligjor qe kane te bejne me pronesine e mjetit ose qiramarrjen e tij sipas rastit, te shoqeruara edhe me dokumentat e tjera te percaktuara ne shkronjat b', ,c', ,d' dhe ,e', te pikes 3.3.4 te Shtojces 8, te cilat kane efekt dokumentues per rregullshmerine e levizjes (qarkullimit) te mjetit ne rruge, si leje qarkullimi, siguracion, akt i kontrollit teknik.

Lidhur me referimin qe subjekti ankimues ben ne ankese se "pronesia (e mjeteve) eshte e shprehur edhe ne bilancet e dorezuara ne SPE ... ", ky pretendim pasi u verifikua ne dosjen e tenderit, nuk rezulton i vertete. Pra, pasi u keqyren bilancet e Devis shpk, rezulton se ne seksionin pasqyra e pozicionit financiar (bilanci), tek aktivet materiale nuk ka asnje te dhene ne lidhje me identifikimin e mjeteve te prezantuara ne tender nga subjekti apo nje listim i tyre qe tregon pronesine, pervec se vlerave te ketyre aktiveve (pra, vetem shifra).

Lidhur me referimin tek Ligji nr.10076 date 12.2.2009 "Per sigurimin e detyrueshem ne fushen e transportit" i ndryshuar, te cilin subjekti ankimues e perdor per te provuar ne menyre te terthorte pretendimet e tij, ky i fundit ka cituar nenin 4 te ketij Ligji, ku thuhet:

"Neni 4

Detyrimi per t'u siguruar

1. Pronari i cdo mjeti transporti, perpara perdorimit te mjetit, eshte i detyruar te lidhe nje kontrate sigurimi, sipas pikes 1 te nenit 2 te ketij ligji, si dhe te siguroje rinovimin e saj per aq kohe sa mjeti i transportit do te mbetet ne qarkullim.

2. Kur mjeti i transportit eshte subjekt i detyrimit per t'u regjistruar apo licencuar dhe sipas ligjit duhet te kete nje certifikate apo licencimi, autoritetet pergjegjese mund ta leshojne certifikaten e regjistrimit ose ndonje dokument tjeter, te barasvlershem me te, vetem pasi pronari i mjetit te transportit provon me dokumente se e ka kontraten e sigurimit, sipas ketij ligji.

Subjekti ankimes ka cituar nenin 4 te Ligji nr.10076 date 12.2.2009, por ai nuk ka pasur ne vemendjen e tij percaktimet e nenit 2 te ketij Ligji, te cilat sqarojne se:

"Neni 2

Fusha e veprimit

1. Sigurimi i detyrueshem ne sektorin e transportit perfshin:

a) sigurimin e pasagjereve nga aksidentet ne transportin publik;

b) sigurimin e pergjegjesise se pronarit ose te perdoruesit te mjetit motorik, qe me poshte do te referohet si sigurimi i pronarit, per demet shkaktuar paleve te treta nga perdorimi i ketij mjeti

Pra shprehja 'pronar' ne piken 1 te nenit 4, sqarohet ne shkronjen 'b' te pikes 1, te nenit 2 te Ligjit.

Gjithashtu ne nenin 3 te ketij Ligji, "Perkufizime", sqarohet shprehimisht se perdoruesi i mjetit, pra ai qe per efekt te qarkullimit te mjetit ne rruge, pajiset me dokumentacionin e kerkuar nga ligji, si siguracioni, akti i kontrollit teknik, leja e qarkullimit, etj., mund te jete pronari i mjetit, por mund te jete edhe perdoruesi i mjetit, i cili sic thote ligji "perdor mjetin e transportit me miratimin e pronarit".

"Neni 3

Perkufizime

Ne kete ligj termat e meposhtem kane keto kuptime:

1. "Aksident" eshte ngjarja, ku rezulton dem nga perdorimi i mjetit te transportit.

2. "Mjet transporti" eshte mjeti motorik, avioni dhe mjeti lundruar.

3. "Mjet motorik" eshte mjeti qe leviz ne toke, por jo mbi shina, me ane te fuqise motorike, pavaresisht nga numri i rrotave. Mjet motorik eshte edhe rimorkioja dhe gjysmerimorkioja, te bashkuara ose jo me mjetin motorik terheqes.

4. "Perdorues i nje mjeti transporti" eshte nje person fizik apo juridik, qe perdor mjetin e transportit me miratimin e pronarit.

5. "Drejtues" eshte personi qe drejton mjetin e transportit.

Pra eshte evidente se ligji ben nje ndarje te qarte midis pronarit te mjetit dhe perdoruesit te mjetit i cili e perdor ate me miratimin e pronarit, por qe, qe te dy pajisen me policen e sigurimit te detyrueshem te mjetit.

Pavaresisht sqarimeve te mesiperme, sic e kemi sqaruar edhe me siper, zyrtari i ngarkuar me shqyrtimin e ankeses, analizen dhe shqyrtimin qe i ben ankeses dhe pretendimeve te saj, si dhe vendimin per refuzimin e saj, e bazon ngushtesisht ne dispozitat e Ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, ne rregullat e prokurimit publik, ne kriteret apo kushtet

e percaktuara ne DST, ne qendrimet ligjore dhe te konsoliduara qe ka mbajtur Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), si dhe ne parimin ligjor prokurues qe cdo operator ekonomik pjesemarrës ne nje gare prokurimi, duhet te dorezoje dokumentacionin e kerkuar per cdo kriter te vendosur ne kerkesat per kualifikim, per sa kohe qe nuk e ka kontestuar ate kriter.

Ne perfundim te shqyrtimit te ceshtjes dhe rrethanave te saj, Autoriteti Kontraktor me shqyrtimin e ankeses, pasi analizoi me kujdes pretendimet e ankimuesit te parashtruara ne ankese, provat shkresore te paraqitura, pasi verifikoi dokumentacionin e ofertes se Devis shpk, te shkarkuar nga sistemi elektronik i prokurimeve (SPE), si dhe nga informacioni i teresise se dosjes se ketij tenderi, pasi u konsultua me dispozitat e Ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar, gjykon se pretendimet e subjektit ankimues nuk qendrojne, pasi nuk gjejne mbeshtetje ne ligjin nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, dhe ne kete kushte kjo ankese nuk pranohet."

II.3.2. Në datën 03.02.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor. Për më tepër në KPP ankimuesi ngre pretendime shtesë si vijon:

"[...] Me date 27.01.2020 nepermjet sistemit elektronik te prokurimit publik u njoftuam per rivleresimin e procedures nga KVO nga ku rezulton se eshte kualifikuar operatori ekonomik KOMBI INVEST si me poshte:

1. "Devis" sh.p.k 141.307.110 lekë, skualifikuar
2. "Kombi Invest" sh.p.k 156.132.774 lekë, kualifikuar
3. "Sanitary Cleaning" sh.p.k 159.839.190 lekë, skualifikuar

Autoriteti kontraktor ne shkelje te plote te Ligjit per Prokurimin Publik Nr. 9643, date 20.11.2006 (i ndryshuar) neni 63 ka rivlersuar proceduren e prokurimit duke kualifikuar oferten e bashkimi te operatoreve Ekonomik Shoqerise Alfa Cleaning, shoqerise KOMBI INVEST.

Ne nenin pikat 2 dhe 3 63 te LPP eshte percaktuar se:

2. Ankesa kunder vendimeve te autoritetit kontraktor i paraqitet, se pari, me shkrim, autoritetit kontraktor ne fjale brenda 7 diteve, nga dita e neserme e punes, kur ankimuesi eshte vene ne dijeni ose duhet te ishte vene ne dijeni per shkeljen e pretenduar, sipas ketij ligji.

3. Me marrjen e ankeses me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedures se prokurimit, derisa ankesa te jete shqyrtuar plotesisht, perfshire dhe nxjerrjen e nje vendimi perpara skadimit te afatit kohor, te percaktuara ne pikat 5 dhe 6 te ketij neni.

Sa me siper Autoriteti kontraktor nuk duhet te kishte kryer asnje veprim procedural deri ne shqyrtimin e plote te ankeses se paraqitur nga ana jone. Veprimet e kryera bien ne kundershtrim te hapur me dispozitat e siperpermendura.

Se dyti, Autoriteti Kontraktor me kualifikimin e operatorit ekonomik KOMBI INVEST shpk ka shkelur nenin 53 shqyrtimi i ofertave, pikat 3 dhe 5 pasi ky bashkim operatoresh nuk ploteson pjesen me te madhe te kriterave kualifikuese te percaktuara ne dokumentat standarte te tenderit pasi ka kualifikuar pa te drejte bashkimin e operatoreve Ekonomik Alfa Cleaning dhe shoqerise KOMBI INVEST dhe shkeljet ligjore te kryera nga AK.

Me date 30/01/2020 kemi paraqitur ankese te argumentuar ne lidhje me kualifikimin pa te drejte te bashkimit te operatoreve Ekonomik Shoqerise Alfa Cleaning shpk dhe shoqerise Kombi Invest shpk dhe jemi duke pritur pergjigjen ne respekt te afateve te percaktuara ne nenin 63 te Ligjin nr. 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik".

Gjithashtu pretendohet se autoriteti kontraktor nuk ka kthyer pergjigje brenda afateve ligjore.

II.3.3. Në datën 13.02.2020 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 137/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 513 prot., datë 11.02.2020, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

II.4. Në datën 27.01.2020 autoriteti kontraktor ka bërë rivlerësimin e procedurës së prokurimit në SPE. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

- | | | |
|----|----------------------------|--------------------------------|
| 1. | “Devis ” sh.p.k | 141.307.110 lekë, skualifikuar |
| 2. | “Kombi Invest” sh.p.k | 156.132.774 lekë, kualifikuar |
| 3. | “Sanitary Cleaning” sh.p.k | 159.839.190 lekë, skualifikuar |

II.5. Në datën 30.01.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur përsëri ankesë pranë autoritetit kontraktor duke pretenduar si vijon:

[...] Me date 27.01.2020 nepermjet sistemit elektronik te prokurimit publik u njoftuam per rivleresimin e procedures nga KVO nga ku rezulton se eshte kualifikuar operatori ekonomik KOMBI INVEST si me poshte:

- | | | |
|----|----------------------------|--------------------------------|
| 1. | “Devis ” sh.p.k | 141.307.110 lekë, skualifikuar |
| 2. | “Kombi Invest” sh.p.k | 156.132.774 lekë, kualifikuar |
| 3. | “Sanitary Cleaning” sh.p.k | 159.839.190 lekë, skualifikuar |

Autoriteti kontraktor ne shkelje te plote te Ligjit per Prokurimin Publik Nr. 9643, date 20.11.2006 (i ndryshuar) neni 63 ka rivlersuar proceduren e prokurimit duke kualifikuar oferten e bashkimi te operatoreve Ekonomik Shoqerise Alfa Cleaning, shoqerise KOMBI INVEST.

Ne nenin 63 pikat 2 dhe 3 te LPP eshte percaktuar se:

2. Ankesa kunder vendimeve te autoritetit kontraktor i paraqitet, se pari, me shkrim, autoritetit kontraktor ne fjale brenda 7 diteve nga dita e neserme e punes kur ankimuesi eshte vene ne dijeni ose duhet te ishte vene ne dijeni per shkeljen e pretenduar, sipas ketij ligji.

3. Me marrjen e ankeses me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedures se prokurimit, derisa ankesa te jete shqyrtuar plotesisht, perfshire dhe nxjerrjen e nje vendimi perpara skadimit te afatit kohor, te percaktuara ne pikat 5 dhe 6 te ketij neni.

Sa me siper Autoriteti kontraktor nuk duhet te kish kryer asnje veprim procedural deri ne shqyrtimin e plote te ankeses se paraqitur nga ana jone. Veprimet e kryera bien ne kundershkrim te hapur me dispozitat e siperpermendura.

Se dyti, Autoriteti Kontraktor me kualifikimin e operatorit ekonomik KOMBI INVEST shpk ka shkelur nenin 53 shqyrtimi i ofertave, pikat 3 dhe 5 pasi ky bashkim operatoresh nuk ploteson pjesen me te madhe te kritereve kualifikuese te percaktuara ne dokumentat standarde te tenderit.

Me poshte po ju paraqesin disa fakte te pa kontestueshme qe faktojne kualifikimin e pa drejte te bashkimit te operatoreve Ekonomik Alfa Cleaning dhe shoqerise KOMBI INVEST dhe shkeljet ligjore te kryera nga AK.

Shoqeria Devis shpk se bashku me konsulentet e saj ligjore, ka bere verifikimet e saj ne shtetin Shqiptar ku ushtrojne aktivitet bashkimi i operatoreve Alfa Cleaning dhe shoqerise KOMBI INVEST. Duke iu referuar te dhenave te mbledhura rezulton se:

Kontrata e bashkepunimit e lidhur ndermjet bashkimit te operatoreve Alfa Cleaning dhe shoqerise KOMBI INVEST nuk eshte ne perputhje me nenin 74 te VKM-se 914 date 29.12.2014 Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik i ndryshuar "Bashkimi i operatoreve ekonomike" pika 2 dhe pika 3.

Para dorezimit te ofertes, bashkimi duhet te krijohet zyrtarisht, me nje marreveshje te noterizuar, ku te percaktohen perfaqesuesi i grupit, perqindja e pjesemarrjes se punes/sherbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, qe do te kryeje secili nga anetaret e ketij bashkimi. Pas krijimit te bashkimit te operatoreve ekonomike, anetaret e bashkimit caktojne me prokure perfaqesuesin e tyre per dorezimin e ofertes. Kjo marreveshje e shkruar dhe prokura duhet te dergohen se bashku me kualifikimet dhe oferten ekonomike, e cila duhet te nenshkruhet nga perfaqesuesi. Perfaqesuesi duhet te beje edhe sigurimin e ofertes, nese kerkohet, duke specifikuar pjesemarrjen ne bashkimin e operatoreve ekonomike. Ne rast se bashkimi i operatoreve ekonomike shpallet fitues, kontrata duhet te nenshkruhet nga secili prej anetareve te ketij bashkimi. Ky bashkim operatorsh ne kontraten e bashkepunimit kane percaktuar se shoqeria KOMBI INVEST sh.p.k merr persiper kryerjen e punimeve dhe sherbimeve ne masen 25% ndersa shoqeria Alfa Cleaning sh.p.k merr persiper kryerjen e punimeve dhe sherbimeve ne masen 75%.

Ne kontraten e bashkepunimit nuk jane percaktuar elementet konkrete, qe do te kryeje secili nga anetaret e ketij bashkimi.

Ne lidhje me Shoqerine Kombi Invest SH.P.K

Operatori ekonomik KOMBI INVEST shpk objektin e veprimtarise qe nga krijimi saj e ka Ndertimi i ndertesave rezidenciale e jo rezidenciale qe nuk ka asnje lidhje apo ngjashmeri me objektin e prokurimit ne fjale Sherbimi i Lavanterise dhe Hotelerise.

Pasi procedura e prokurimit me objekt Sherbimi i Lavanterise dhe Hotelerise ne Spitalin Rajonal Fier eshte publikuar ne sistemin elektronik te prokurimeve me date 22.11.2019 nga Autoriteti Kontrator Spitali Rajonal Fier, shoqeria KOMBI INVEST shpk me date 25.11.2019 e ne vijim ka lidhur kontrata fiktive me subjekte te ndryshme private per ofrimin e sherbimit te larjes tharjes hekurosjes si dhe ka prere fatura tatimore qe i ka paraqitur ne sistemin elektronik per te plotesuar kapacitetet e kerkuara ne DST.

Te gjitha keto fatura tatimore jane fiktive pasi sipas verifikimeve te kryera nga ana jone prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve, nuk jane te deklaruar prane organeve tatimore konform legjislacionit ne fuqi, pra nga kjo shoqeri eshte paraqitur dokumentacion i falsifikuar me qellim kualifikimin e tij ne kete procedure prokurimi.

Nese do te shikonit me vemendje edhe dokumenatcionin qe shoqeria KOMBI INVEST ka paraqitur per marrjen me qera te makinerive ne gjuhen italiane, do te verenit qe ato nuk jane makineri por hekurishte qe shteti Italian i ka shitur per skrab. Kjo nuk mbaron me kaq po te vereni cmimin e blerjeve te makinerive do te verenit qe keto fatura jane per te manipuluar

Autoritetin Kontraktor pasi me keto cmime makinerish nuk blihen dot lavatrice 5 kg per perdorim shtepiak dhe jo me lavatrice industriale te cilat ne kete rast do te sherbenin per sherbimin e lavanderise dhe hoterise se spitalit rajonal Fier.

Eshte mese e qarte dhe e dukshme qe kjo kompani, gjate gjithe periudhes se ushtrimit te veprimtarise se saj qe nga momenti krijimit, nuk ka kryer dhe nuk kryen sherbimin e lavanderise dhe hotelerise. Po te shqyrtohet me kujdes dokumentacioni rezulton qe nuk ka asnje kapacitet teknik dhe njerezor per kryerjen e ketij sherbimi. Te gjitha veprimet e kryera nga kjo kompani nga lidhja e kontratave dhe prerja e faturave per sherbimin e lavanderise dhe hotelerise tregojne qe jane kryer per te bere te munduar te mashtroje Autoritetin Kontraktor me dokumentacion fiktiv dhe te falsifikuar.

Per sa me siper shoqeria jone ju fton te kryeni verifikimet prane administrates tatimore konform percaktimeve ligjore per te vertetuar ate cka kemi parashtuar me siper.

Eshte detyrim i autoritetit kontraktor te kryeje verifikimet e nevojshme dhe te zbatoje aktet ligjore dhe nenligjore qe rregullojne gjithe procesin e prokurimit.

Ne lidhje me Shoqerine Alfa Cleaning sh.p.k

Operatori ekonomik Alfa Cleaning, per te permbushur kriterin e percaktuar ne piken 3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, ne lidhje me sherbimet e ngjashme te kryera gjate tre viteve te fundit, ka paraqitur fatura tatimore te shitjes ne te cilat ka falsifikuar sasine, dhe vleren totale duke i rritur me shume se 10 fish faturat e TVSH-se. Kjo gje konstatohet kryesisht tek faturat tatimore te vitit 2019. Nga nje verifikim i kryer nga ana jone ne organet tatimore rezulton se vlera e faturave tatimore e deklaruar ne organet tatimore nuk eshte e njejte me vleren e faturave te paraqitura ne sistemin elektronik per kete procedure prokurimi.

Ne kriterin 3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar Operatori ekonomik duhet te paraqese kopje te deklaratave te xhiros vjetore ose vertetim nga administrata tatimore, per xhiron e realizuar ne tre vitet e fundit (2016, 2017, 2018) nga data e zhvillimit te procedures, vlera mesatare e te ciles te jete jo me e vogel se 30 % e vleres se fondit limit.

Ne baze te pikes 3 te nenit 74 te VKM-se nr. 914 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" ku percaktohet: Secili prej anetareve te ketij bashkimi duhet te permbushet kerkesat ligjore, te parashikuara ne nenin 45 te LPP-se dhe ato te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Kerkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet te permbushen nga i gjithë bashkimi, ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne pune, sherbim apo fumizim, te percaktuara ne aktmarreveshje.

Sipas perlllogaritjeve kjo kompani duhet ta kishte mesataren e xhiros vjetore per tre vitet e fundit ne vleren 36,485,033 leke.

Nga dokumentacioni i dorezuar nga shoqeria Alfa Cleaning sh.p.k rezulton se per tre vitet e kerkuara ka realizuar xhiro vjetore si me poshte

Viti 2016 ne vleren 9,018,237 leke

Viti 2017 ne vleren 9,831,928 leke

Viti 2018 ne vleren 6,807,050 leke

Me nje perlllogaritje te thjeshte del qarte qe kjo shoqeri nuk e ploteson kriterin e percaktuar ne lidhje me xhiron mesatare vjetore, pasi vleren mesatare te xhiros vjetore per tre vitet e kerkuara e ka 8,552,405 leke.

Ne lidhje me numrin e punonjesve per cilen duhet te kishte Vertetim nga Administrata Tatimore per numrin e punonjesve te siguruar, te shoqeruar dhe me listepagesat (formulari E-sig 025 a) te konfirmuara nga autoritetet perkatese kjo shoqeri, sipas kontrates se bashkepunimit, duhet te kishte te siguruar 10.5 punonjes.

Ne SPE ka paraqitur listepagesat me mesatarisht per 8.8 punonjes ne muaj.

Shoqeria Alfa Cleaning sh.p.k nuk ka paraqitur raporte auditimi per vitet 2016, 2017, 2018.

Gjithashtu nga verifikimet qe kemi kryer prane zyrove OSHEE-se kjo shoqeri ka marre Vertetim se konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjise elektrike te kontratave te energjise qe ka operatori ekonomik qe eshte i regjistruar ne Shqiperi vetem me date 27.12.2017. Pra kjo shoqeri nuk ka paraqitur vertetim qe konfirmon shlyerjen e detyrimeve te energjise elektrike per muajin nentor 2019.

Bazuar ne VKM-ne 914 date 29.12.2014 Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik i ndryshuar, neni 26 Mosshlyerja e detyrimeve te energjise elektrike perben shkak per skualifikimin e operatorit ekonomik.

Kompania Alfa Cleaning sh.p.k nuk permbush kriterin 3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike:

Nuk disponon asnje nga certifikatat ISO si me poshte:

3.1.1. Operatori ekonomik duhet te paraqese Certifikate qe verteton cilesine e menaxhimit te shoqerise, ISO 9001 (e vlefshme). Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kornbetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise.

3.1.2. Operatori ekonomik duhet te paraqese Certifikate qe verteton cilesine e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune ISO 18001 (e vlefshme) ose ISO 45001 (e vlefshme). Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise.

3.1.3. Operatori ekonomik duhet te paraqese Certifikate e vlefshme qe verteton sistemin e kontrollit te Biokontaminimit SSH EN 14065:2016 I UNI ENI 14065. Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise.

Ne kushtet kur oferta jone eshte skualifikuar vetem pasi per gabime njerezore te mosparaqitjes se certifikates se pronesise se mjetit por qe ky fakt vertetohej lehtesisht nga nje sere dokumentash te tjere ligjore si Leja e qarkullimit, Siguracion, certifikaten e kontrollit teknik, gjithashtu keto mjete jane te pasqyruara ne bilancet e shoqerise si dhe ne ekstraktin e rregjistrimit ne QKB, pra eshte vertetuar qe keto mjete jane ne pronesi te shoqerise Devis shpk.

Nje vendim absolutisht i padrejte dhe i bazuar ne pretendime hipotetike dhe jo ne fakte qe ekzistojne i cili na skualifikon pa asnje arsye, ne kundërshtim te hapur me rregullat e prokurimit publik. Shoqeria Devis ka plotesuar ne menyre te perpikte te gjitha dokumentat tekniko ligjore, sipas te gjitha kerkesave te pergjithshme dhe te vecanta te kualifikimit te kerkuara nga Ak, ndaj subjektit tone, por nga ana tjeter po i shkaktohet nje dem ekonomik relativisht i madh buxhetit te shtetit pasi po te krahasohen ofertat ekonomike eshte nje diference prej me shume se 15 milion leke. Kjo diference i rendon buxhetit te shtetit vetem e vetem qe te shpallet fitues nje operator ekonomik i cili ka falsifikuar pjesen me te madhe te dokumentacionit si dhe ka mungesa te theksuara

kapacitetesh teknike dhe nuk ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar, pasi objekti i veprimtarise se tij nuk eshte sherbimi i lavanderise objekt i kesaj kontrate.

Per sa parashtruam me siper Autoriteti kontraktorne menyre demonstrative ka shkelur nje nga parimet baze te percaktuara ne nenin 2 te Ligjit nr 9643, dt 20.11.2006 "Perprokurimin Publik", i ndryshuar, mosdiskriminim dhe trajtimi barabarte i ofertuesve ose kandidateve.

Ne respektim te plote te Ligjit per Prokurimin Publik dhe akteve te tjera ligjore per zbatimin e tij, i kerkuam Autoritetit Kontraktor te verifikonte faktet e paraqitura nga ana jone si dhe te bente rivleresimin e procedures duke kualifikuar oferten e operatorit ekonomik DEVIS shpk si oferte e vlefshme dhe duke s'kualifikuar oferten e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik.

II.5.1. NËpërmjet shkresës nr. 444 prot., datë 06.02.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit duke e refuzuar ankesën si më poshtë:

“ [...] Lidhur me pretendimin e subjektit ankimes se shoqeria DEVIS shpk nuk ka marre pergjigje ne lidhje me ankesen nr.250 prot. date 22.01.2020, nga verifikim i dokumentacionit te ketij tenderi te administruar ne dosjen perkatese, rezulton se autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Fier i ka derguar subjektit ankimes "DEVIS" sh.p.k., pergjigje me shkrim me shkresen nr.prot.355 date 27.01.2020, per rezultatet e shqyrtimit te ankeses nr.250 prot., date 22.01.2020, duke i parashtruar ne kete shkrese arsyet dhe argumentat ligjore te mospranimi te ankeses.

Shkresa me nr.prot.355 date 27.01.2020 "Kthim pergjigje lidhur me ankesen e operatorit ekonomik "Devis" shpk, per ankesen me nr.250 prot. date 22.01.2020", eshte derguar me poste te rregullt, nga Posta Shqiptare sh.a. Fier. Shkresa me nr.prot. 355 date 27.01.2020 eshte derguar drejtuar operatorit ekonomik "Devis" shpk, ne adresen Rruga Sami Frasheri, pall 22/1, Tirane, e cila eshte e njejta adrese qe operatori ekonomik "Devis" shpk ka deklaruar ne formularin e ankeses nr.250 prot. date 22.01.2020 kjo eshte lehtesisht e verifikueshme, pasi po kjo adrese eshte e deklaruar edhe ne ankesen me nr.prot.384, date 30.01.2020.

Por, sic eshte e dukshme ne zarfin postar te vulosur nga Posta Shqiptare (bashkelidhur), posta ka deklaruar me shenimin ne zarfe "Adrese e pasakte", duke kthyer mbrapsh zarfin dhe shkresen e sipercituar.

Bashkelidhur ne cilesine e proves shkresore kopje e zarfit postar te vulosur nga Posta Shqiptare, e cila verteton sa me siper.

Ne keto kushte del e vertetuar se pergjegjesia per mos marrjen e njoftimit sipas shkreses me nr.prot.355, date 27.01.2020 eshte ekskluzivisht e vete operatorit ekonomik "Devis" shpk. Autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Fier, sic provohet apo mund te verifikohet ne Posten Shqiptare, e ka derguar rregullisht njoftimin ne adresen e deklaruar nga subjekti ne ankesen e tij. Eshte pergjegjesi e subjektit qe per adresen e kontaktit qe ai vete deklaroi, te marr masa per marrjen e njoftimit.

Lidhur me pretendimin e subjektit ankimes se "autoriteti kontraktor ne shkelje te plote te Ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar, neni 63, ka rivleresuar proceduren e prokurimit, duke kualifikuar oferten e bashkimit te operatoreve Ekonomik Shoqerise Alfa Cleaning dhe shoqerise KOMBI INVEST, sqarojme se autoriteti

kontraktor Spitali Rajonal Fier, ne rastin e shqyrtimit te ankesave te ardhura nga Operatoret Ekonomike pjesmarres ne gare, per proceduren e prokurimit me Nr.REF-44572-11-22-2019 me objekt "Sherbimi i Lavanterise dhe Hotelerise ne Spitalin Rajonal Fier" (Marreveshje Kuader me nje operator ekonomike - ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 36 mujor), ka vepruar bazuar ne dispozitat e Ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe ne procedurat dhe rregullat e prokurimit te percaktuara ne V.K.M nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar.

Ne shkronjen 'ç', te pikes 6, te nenit 78 te V.K.M. nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar, citohet shprehimisht se:

"c) Ne perfundim te shqyrtimit te ankeses, komisioni/zyrtari i ngarkuar per shqyrtimin e saj mund te marre vendim per refuzimin ose pranimin e ankeses, i cili i komunikohet menjehere titullarit te autoritetit kontraktor. Ne rastin kur ankesa eshte pranuar, titullari i autoritetit kontraktor i adreson vendimin per zbatim komisionit te vleresimit te ofertave.

Bazuar ne dispoziten e mesiperme nenligjore, autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Fier per rastin konkret, ka zbatuar me perpikmeri te gjitha veprimet procedurale, sic ato urdherohen ne shkronjen 'ç' te pikes 6, te nenit 78 te V.K.M. nr.914 date 29.12.2014.

Pra, duke qene se ne perfundim te shqyrtimit te ankeses, zyrtari i ngarkuar per shqyrtimin e saj ka marre vendim per pranimin e ankeses se paraqitur nga BOE "Kombi Invest" shpk & "Alfa Cleaning" shpk, zyrtari i ngarkuar per shqyrtimin e ankeses, ka kryer veprimin procedural, duke ia komunikuar menjehere kete vendim Titullarit te autoritetit kontraktor.

Duke qene se ankesa e BOE "Kombi Invest" sh.p.k & "Alfa Cleaning" sh.p.k eshte pranuar, titullari i autoritetit kontraktor ia ka adresuar per zbatim vendimin e pranimit te ankeses, pra vendimin e kualifikimit te BOE "Kombi Invest" sh.p.k & "Alfa Cleaning" sh.p.k Komisionit te Vleresimit te Ofertave.

Bazuar ne sa me siper, komisioni i vleresimit te ofertave, mbeshtetur ne dispoziten urdheruese, te percaktuar ne shkronjen 'ç', te pikes 6, te nenit 78 te V.K.M nr.914 date 29.12.2014, si dhe ne zbatim te vendimit nr.351 date 27.01.2020 te pranimit te ankeses e BOE "Kombi Invest" shpk & "Alfa Cleaning" shpk, ka bere rivleresimin e kesaj oferte, duke e kualifikuar bashkimin e operatoreve ekonomike "Kombi Invest" sh.p.k, & "Alfa Cleaning" sh.p.k. Keto veprime te autoriteti kontraktor jane ne perputhje te plote me pikat 5 dhe 6 te nenit 63 te LPP-se. Sqarojme se, autoriteti kontraktor, bazuar ne dispozitat ligjore dhe nenligjore te sipercituara, bazuar ne rregullat e prokurimit publik dhe ne qendrimet e APP-se dhe KPP-se, ne lidhje me kete ceshtje, te cila jane ne harmoni te plote me njera tjetren, ka vepruar ne perputhje me keto dispozita, duke mos cenuar ne asnje moment te drejten e kujdo operatori ekonomik pjesmarres ne kete gare, qe ka interes te ligjshem ne kete procedure prokurimi, per te ngritur pretendimet e tij ne lidhje me vendimmarrjen e autoritetit kontraktor. Bejme me dije se autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Fier, ne zbatim te rregullave te prokurimit publik, duke qene se per kete procedure prokurimi jane paraqitur 2 (dy) ankesa, ka pezulluar proceduren e prokurimit dhe nuk ka proceduar me njoftimin e fituesit, ne respekt te afateve te ankimimit, te percaktara ne nenin 63 te Ligji nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar.

Duke respektuar procedurën apo rradhën e veprimeve të percaktuara në shkronjën 'ç', e pikes 6, të nenit 78 të V.K.M nr.914 datë 29.12.2014, autoriteti kontraktor nëpërmjet kryerjes së rivleresimit, i cili është një tregër që AK-se ia japin ligji dhe rregullat e prokurimit, nuk i ka cenuar asnjë të drejtë procedurale subjektit ankues, në kuptimin që ky i fundit, ashtu si edhe cdo operatori ekonomik pjesëmarrës në këto gara, nëpërmjet procesit të rivleresimit, është vënë në dijeni dhe është njoftuar nga sistemi elektronik i prokurimeve, për klasifikimin e ofertave apo vendimet e autoritetit kontraktor.

Autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Fier, në asnjë rast nuk ka kryer dhe nuk do të kryejë veprime të cilat të cenojnë mbarevajtjen e procesit apo të drejtat e pjesëmarrësve në gara që do të thote se autoriteti kontraktor nuk ka kryer dhe nuk do të kryejë asnjë veprim për shpalljen e fituesit, derisa ankesa/t të jenë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të shqyrtimit të ankesave nga ky i fundit.

Duhet të kuptojmë ndryshimin ndërmjet njoftimit të klasifikimit të ofertave dhe njoftimit të fituesit. Thëksojmë se ligji dhe rregullat e prokurimit publik, përcaktojnë se të drejten për të marrë një vendim për praninë ose jo të ankesës dhe si rrjedhojë edhe për të urdheruar KVO për të bërë rivleresim të ofertave (sipas rastit) e kanë si KPP-ja, ashtu edhe AK në cilësinë e organit i cili shqyrton ankesën. Ndryshe çfarë kuptimi do të kishin përcaktimet në shkronjën 'ç', e pikes 6, të nenit 78 të V.K.M nr.914 datë 29.12.2014. Çfarë kuptimi do të kishte shprehja se "Në rastin kur ankesa është pranuar, titullari i autoritetit kontraktor i adreson vendimin për zbatim komisionit të vleresimit të ofertave."

Është pikërisht kjo dispozitë, e cila në harmoni të plotë me pikat 3, 5 dhe 6 të nenit 63 të LPP-se, e vënë AK në një pozitë procedurale ligjore vendimtare me të drejta të plota që në rast pranimit të një ankesë, të urdherojë KVO për zbatim të vendimit të komisionit të shqyrtimit të ankesave, pra të urdherojë KVO për të bërë rivleresim, në zbatim të vendimit që ka marrë komisioni i shqyrtimit të ankesave.

Ky është edhe kuptimi i pikes 3 të nenit 63 të LPP-se. Kjo pikë nuk i heq të drejten AK të disponojë mbi ankesën e ardhur në AK dhe si rrjedhojë nuk i heq të drejten AK të bëjë rivleresim të ofertës në rastin kur e ka pranuar ankesën. Kjo pikë urdheron AK që me marrjen e ankesës të pezullojë vazhdimin e procedurës së prokurimit, që do të thote shpalljen e fituesit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të ofatit kohor, të percaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.

Kuptimi i pikes 3 të nenit 63 (i cili harmonizohet edhe në VKM dhe në manualin operacional të APP nr.2/2018), është që AK për të shpallur njoftimin e fituesit në një procedurë prokurimi. duhet të respektojë afatet (secilin me radhë) të percaktuar në pikat 5 dhe në pikat 6 të nenit 63, për secilin nga fazat që ato përfaqësojnë.

Pasi ankuesi është njoftuar për përgjigjen e ankesës, nëse nuk është dakort me atë, atëherë në bazë të pikes 6 i drejtohet KPP, duke e ankuar. Perseri AK nuk shpall fituesin, por pret rezultatet e shqyrtimit të ankesës në KPP.

Në këto kuptime, subjektit ankues nuk i është mohuar e drejta për të ankuar, sic e ka ushtruar konkretisht nëpërmjet paraqitjes së kësaj ankesë, në përfundim të shqyrtimit të së cilës, nëse nuk bie dakort me vendimin e autoritetit kontraktor, ka të drejtën ligjore të paraqesë ankesën e tij në Komisionin e Prokurimit Publik (pika 2 e nenit 63 të LPP-se).

Ne kete menyre te gjithe operatoret ekonomik pjesemarres ne kete gare, kane te drejten dhe mundesine procedurale qe te paraqesin ankesat e tyre sic percakton LPP, pra ne fillim ne autoritetin kontraktor (pika 2 e nenit 63 te LPP-se), dhe me pas ne Komisionin e Prokurimit Publik (pika 2 e nenit 63 te LPP-se), ne rastet kur ankesa e tyre eshte refuzuar nga AK.

Lidhur me kerkesen e parashtruar ne ankesen per kualifikimin e operatorit ekonomik DEVIS shpk si oferte e vlefshme dhe skualifikimin e ofertes se bashkimit te operatoreve ekonomike Alfa Cleaning dhe shoqerise Kombi Invest, subjekti ankues nuk ka parashtruar asnje argument ligjor apo prova shkresore ne lidhje me pretendimet e tij apo per te provuar pretendimet e tij.

Subjekti ankues edhe pse eshte njoftuar me shkrim sipas shkreses nr.prot.355 date 27.01.2020. per arsyet e skualifikimit dhe argumentat dhe shkaqet ligjore te mos pranimit te ankese se tij nr.250 date 22.01.2020, perseri edhe ne kete ankese nr.384 date 30.01.2020, te paraqitur prane autoritetit kontraktor, pas rivleresimit te bere, nuk ka paraqitur asnje argument ligjor apo prova shkresore per te bazuar kerkesen e tij per kualifikimin e operatorit ekonomik DEVIS shpk.

Lidhur me kerkesen e subjektit ankues per skualifikimin e ofertes se bashkimit te operatoreve ekonomik Alfa Cleaning dhe shoqerise Kombi Invest, konstatojme se kesaj kerkese i mungon baza ligjore. Gjithashtu ne baze te rregullave te prokurimit dhe mbeshtetur ne qendrimet ligjore dhe te konsoliduara qe ka mbajtur Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), ne trajtimin qe kjo e fundit i ka bere ceshtjeve te ngjashme, subjekti ankimues nuk legjitimohet te ankohet per operatoret e tjere konkurrenente, por ai ne ankese duhet te sillte argumenta ligjore dhe prova shkresore nepermjet te cileve do te bazonte kerkesen per kualifikimin e ofertes se tij. Subjekti ankimues, bashkengjitur ankeses nuk ka paraqitur prova shkresore per te provuar pretendimet e tij ne lidhje me dokumentacionin e operatorit tjeter ekonomik.

Subjekti ankimues nuk ka paraqitur prova shkresore ose dokumentacion perkares, ne baze te te cilave do te shqyrtohej kjo ankese.

Ne keto kushte, si dhe ne perfundim te shqyrtimit te ceshtjes dhe rrethanave te saj, autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Fier, pasi analizoi pretendimet e ankimuesit, te parashtruara ne ankese, pasi u konsultua me dispozitat e Ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar, V.K.M nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe ne qendrimet ligjore dhe te konsoliduara qe ka mbajtur Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), ne trajtimin qe ky e fundit i ka bere ceshtjeve te ngjashme, ku jane shtjelluar dhe argumentuar analiza dhe vendimmarrja, qe ajo i ka bere pretendimeve te ngjashme, duke shprehur konsideraten se subjekti ankimues ne keqperdorim te ligjit, ka perdorur ne menyre abuzive te drejten qe i jep ligji per t'u ankuar per skualifikimin e ofertes se tij, duke iu referuar ne menyre te pabazuar, pa argumente te arsyeshme dokumentacionit te operatoreve te tjere, pa sqaruar per rrethanat e disponimit te ketyre dokumentave, gjykon se pretendimet e subjektit ankues nuk qendrojne, pasi nuk gjejne mbeshtetje ne ligjin nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, dhe ne keto kushte kjo ankese nuk pranohet."

II.5.2. Në datën 14.02.2020 ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke pretenduar si me poshtë:

[...]Me date 27.01.2020 nepermjet sistemit elektronik te prokurimit publik u njoftuam per rivleresimin e procedures nga KVO nga ku rezulton se eshte kualifikuar operatori ekonomik KOMBI INVEST si me poshte:

"Devis" sh.p.k	141.307.110 lekë, skualifikuar
"Kombi Invest" sh.p.k	156.132.774 lekë, kualifikuar
"Sanitary Cleaning" sh.p.k	159.839.190 lekë, skualifikuar

Autoriteti kontraktor ne shkelje te plote te Ligjit per Prokurimin Publik Nr. 9643, date 20.11.2006 (i ndryshuar) neni 63 ka rivlersuar proceduren e prokurimit duke kualifikuar oferten e bashkimi te operatoreve Ekonomik Shoqerise Alfa Cleaning, shoqerise KOMBI INVEST.

Ne nenin pikat 2 dhe 3 63 te LPP eshte percaktuar se:

2. Ankesa kunder vendimeve te autoritetit kontraktor i paraqitet, se pari, me shkrim, autoritetit kontraktor ne fjale brenda 7 diteve nga dita e neserme e punes kur ankimesi eshte vene ne dijeni ose duhet te ishte vene ne dijeni per shkeljen e pretenduar, sipas ketij ligji.

3. Me marrjen e ankeses me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedures se prokurimit, derisa ankesa te jete shqyrtuar plotesisht, perfshire dhe nxjerrjen e nje vendimi perpara skadimit te afatit kohor, te percaktuara ne pikat 5 dhe 6 te ketij neni.

Sa me siper Autoriteti kontraktor nuk duhet te kish kryer asnje veprim procedural deri ne shqyrtimin e plote te ankeses se paraqitur nga ana jone. Veprimet e kryera bien ne kundershtrim te hapur me dispozitat e siperpermendura.

Se dyti, Autoriteti Kontraktor me kualifikimin e operatorit ekonomik KOMBI INVEST shpk ka shkelur nenin 53 shqyrtimi i ofertave, pikat 3 dhe 5 pasi ky bashkim operatoresh nuk ploteson pjesen me te madhe te kritereve kualifikuese te percaktuara ne dokumentat standarde te tenderit.

Me poshte po ju paraqesin disa fakte te pa kontestueshme qe faktojne kualifikimin e pa drejte te bashkimit te operatoreve Ekonomik Alfa Cleaning dhe shoqerise KOMBI INVEST dhe shkeljet ligjore te kryera nga AK.

Shoqeria Devis shpk se bashku me konsulentet e saj ligjore, ka bere verifikimet e saj ne shtetin Shqiptar ku ushtrojne aktivite bashkimi i operatoreve Alfa Cleaning dhe shoqerise KOMBI INVEST. Duke iu referuar te dhenave te mbledhura rezulton se:

Kontrata e bashkepunimit e lidhur ndermjet bashkimit te operatoreve Alfa Cleaning dhe shoqerise KOMBI INVEST nuk eshte ne perputhje me nenin 74 te VKM-se 914 date 29.12.2014 Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik i ndryshuar "Bashkimi i operatoreve ekonomike" pika 2 dhe pika 3. Para dorezimit te ofertes, bashkimi duhet te krijohet zyrtarisht, me nje marreveshje te noterizuar, ku te percaktohen perfaqesuesi i grupit, perqindja e pjesemarrjes se punes/sherbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, qe do te kryeje secili nga anetaret e ketij bashkimi. Pas krijimit te bashkimit te operatoreve ekonomike, anetaret e bashkimit caktojne me prokure perfaqesuesin e tyre per dorezimin e ofertes. Kjo marreveshje e shkruar dhe prokura duhet te dergohen se bashku me kualifikimet dhe oferten ekonomike, e cila duhet te nenshkruhet nga perfaqesuesi. Perfaqesuesi duhet te beje edhe sigurimin e ofertes, nese kerkohet, duke specifikuar pjesemarrjen ne bashkimin e operatoreve ekonomike. Ne rast se bashkimi

i operatoreve ekonomike shpallet fitues, kontrata duhet te nenshkruhet nga secili prej anetareve te ketij bashkimi.

Ky bashkim operatoresh ne kontraten e bashkepunimit kane percaktuar se shoqeria KOMBI INVEST sh.p.k merr persiper kryerjen e punimeve dhe sherbimeve ne masen 25% ndersa shoqeria Alfa Cleaning sh.p.k merr persiper kryerjen e punimeve dhe sherbimeve ne masen 75%. Ne kontraten e bashkepunimit nuk jane percaktuar elementet konkrete, qe do te kryeje secili nga anetaret e ketij bashkimi.

Ne lidhje me Shoqerine Kamb Invest SH.P.K

Operatori ekonomik KOMBI INVEST shpk objektin e veprimtarise qe nga krijimi saj e ka Ndertimi i ndertesave rezidenciale e jo rezidenciale qe nuk ka asnje lidhje apo ngjashmeri me objektin e prokurimit ne fjale Sherbimi i Lavanterise dhe Hotelerise.

Pasi procedura e prokurimit me objekt Sherbimi i Lavanterise dhe Hotelerise ne Spitalin Rajonal Fier eshte publikuar ne sistemin elektronik te prokurimeve me date 22.11.2019 nga Autoriteti Kontrator Spitali Rajonal Fier, shoqeria KOMBI INVEST shpk me date 25.11.2019 e ne vijim ka lidhur kontrata fiktive me subjekte te ndryshme private per ofrimin e sherbimit te larjes tharjes hekurosjes si dhe ka prere fatura tatimore qe i ka paraqitur ne sistemin elektronik per te plotesuar kapacitetet e kerkuara ne DST.

Te gjitha keto fatura tatimore jane fiktive pasi sipas verifikimeve te kryera nga ana jone prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve, nuk jane te deklaruar prane organeve tatimore konform legjislacionit ne fuqi, pra nga kjo shoqeri eshte paraqitur dokumentacion i falsifikuar me qellim kualifikimin e tij ne kete procedure prokurimi.

Nese do te shikonit me vemendje edhe dokumenatcionin qe shoqeria KOMB INVEST ka paraqitur per marrjen me qera te makinerive ne gjuhen italiane, do te verenit qe ato nuk jane makineri por hekurishte qe shteti Italian i ka shitur per skrab. Kjo nuk mbaron me kaq po te vereni cmimin e blerjeve te makinerive do te verenit qe keto fatura jane per te manipuluar Autoritetin Kontraktor pasi me keto cmime makinerish nuk blihen dot lavatrice 5 kg per perdorim shtepiak dhe jo me lavatrice industriale te cilat ne kete rast do te sherbenin per sherbimin e lavanderise dhe hoterise se spitalit rajonal Fier.

Eshte mese e qarte dhe e dukshme qe kjo kompani gjate gjithe periudhes se ushtrimit te veprimtarise se saj qe nga momenti krijimit, nuk ka kryer dhe nuk kryen sherbimin e lavanderise dhe hotelerise. Po te shqyrtohet me kujdes dokumentacioni rezulton qe nuk ka asnje kapacitet teknik dhe njerezor per kryerjen e ketij sherbimi. Te gjitha veprimet e kryera nga kjo kompani nga lidhja e kontratave dhe prerja e faturave per sherbimin e lavanterise dhe hotelerise tregojne qe jane kryer per te bere te munduar te mashtroje Autoritetin Kontraktor me dokumentacion fiktiv dhe te falsifikuar.

Per sa me siper shoqeria jone ju fton te kryeni verifikimet prane administrates tatimore konform percaktimeve ligjore per te vertetuar ate cka kemi parashtuar me siper.

Eshte detyrim i autoritetit kontraktor te kryeje verifikimet e nevojshme dhe te zbatoje aktet ligjore dhe nenligjore qe rregullojne gjithe procesin e prokurimit.

Ne lidhje me Shoqerine Alfa Cleaning sh.p.k

Operatori ekonomik Alfa Cleaning, per te permbushur kriterin e percaktuar ne piken 3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, ne lidhje me sherbimet e ngjashme te kryera gjate tre viteve

te fundit, ka paraqitur fatura tatimore te shitjes ne te cilat ka falsifikuar sasine, dhe vleren totale duke i rritur me shume se 10 fish faturat e TVSH-se. Kjo gje konstatohet kryesisht tek faturat tatimore te vitit 2019. Nga nje verifikim i kryer nga ana jone ne organet tatimore rezulton se vlera e faturave tatimore e deklaruar ne organet tatimore nuk eshte e njejte me vleren e faturave te paraqitura ne sistemin elektronik per kete procedure prokurimi.

Ne kriterin 3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar Operatori ekonomik duhet te paraqese kopje te deklaratave te xhiros vjetore ose vertetim nga administrata tatimore, per xhiron e realizuar ne tre vitet e fundit (2016, 2017, 2018) nga data e zhvillimit te procedures, vlera mesatare e te ciles te jete jo me e vogel se 30 % e vleres se fondit limit.

Ne baze te pikes 3 te nenit 74 te VKM-se nr. 914 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" ku percaktohet: Secili prej anetareve te ketij bashkimi duhet te permbush kerkesat ligjore, te parashikuara ne nenin 45 te LPP-se dhe ato te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Kerkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet te permbushen nga i gjithë bashkimi, ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne pune, sherbim apo fumizim, te percaktuara ne aktmarreveshje.

Sipas perlllogaritjeve kjo kompani duhet ta kishte mesataren e xhiros vjetore per tre vitet e fundit ne vleren 36,485,033 leke.

Nga dokumentacioni i dorezuar nga shoqeria Alfa Cleaning sh.p.k rezulton se per tre vitet e kerkuara ka realizuar xhiro vjetore si me poshte

Viti 2016 ne vleren 9,018,237 leke

Viti 2017 ne vleren 9,831,928 leke

Viti 2018 ne vleren 6,807,050 leke

Me nje perlllogaritje te thjeshte del qarte qe kjo shoqeri nuk e ploteson kriterin e percaktuar ne lidhje me xhiron mesatare vjetore, pasi vleren mesatare te xhiros vjetore per tre vitet e kerkuara e ka 8,552,405 leke.

Ne lidhje me numrin e punonjesve per cilen duhet te kishte Vertetim nga Administrata Tatimore per numrin e punonjesve te siguruar, te shoqeruar dhe me listepagesat (formularet E-sig 025 a) te konfirmuara nga autoritetet perkatese kjo shoqeri, sipas kontrates se bashkepunimit, duhet te kishte te siguruar 10.5 punonjes.

Ne SEP ka paraqitur listpagesat me mesatarisht per 8.8 punonjes ne muaj.

Shoqeria Alfa Cleaning sh.p.k nuk ka paraqitur raporte auditimi per vitet 2016, 2017, 2018.

Gjithashtu nga verifikimet qe kemi kryer prane zyrave OSHEE-se kjo shoqeri ka marre Vertetim se konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjise elektrike te kontratave te energjise qe ka operatori ekonomik qe eshte i regjistruar ne Shqiperi vetem me date 27.12.2017. Pra kjo shoqeri nuk ka paraqitur vertetim qe konfirmon shlyerjen e detyrimeve te energjise elektrike per muajin nentor 2019.

Bazuar ne VKM-ne 914 date 29.12.2014 Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik i ndryshuar, neni 26 Mosshlyerja e detyrimeve te energjise elektrike perben shkak per skualifikimin e operatorit ekonomik.

Kompania Alfa Cleaning sh.p.k nuk permbush kriterin 3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike:

Nuk disponon asnje nga certifikatat ISO si me poshte:

3.1.1. Operatori ekonomik duhet te paraqese Certifikate qe verteton cilesine e menaxhimit te shoqerise, ISO 9001 (e vlefshme). Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kornbetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise.

3.1.2. Operatori ekonomik duhet te paraqese Certifikate qe verteton cilesine e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune ISO 18001 (e vlefshme) ose ISO 45001 (e vlefshme). Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise.

3.1.3. Operatori ekonomik duhet te paraqese Certifikate e vlefshme qe verteton sistemin e kontrollit te Biokontaminimit SSH EN 14065:2016 I UNI ENI 14065. Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise.

Ne kushtet kur oferta jone eshte skualifikuar vetem per gabime njerezore te mosparaqitjes se certifikates se pronesise se mjetit por qe ky fakt vertetohej lehtesisht nga nje sere dokumentash te tjere ligjore si Leja e qarkullimit, Siguracion, certifikaten e kontrollit teknik, gjithashtu keto mjete jane te pasqyruara ne bilancet e shoqerise si dhe ne ekstraktin e rregjistrimit ne QKB, pra eshte vertetuar qe keto mjete jane ne pronesi te shoqerise Devis shpk.

Nje vendim absolutisht i padrejte dhe i bazuar ne pretendime hipotetike dhe jo ne fakte qe ekzistojne i cili na skualifikon pa asnje arsye, ne kundersizim te hapur me rregullat e prokurimit publik. Shoqeria Devis ka plotesuar ne menyre te perpikte te gjitha dokumentat tekniko ligjore, sipas te gjitha kerkesave te pergjithshme dhe te vecanta te kualifikimit te kerkuara nga Ak, ndaj subjektit tone, por nga ana tjeter po i shkaktohet nje dem ekonomik relativisht i madh buxhetit te shtetit pasi po te krahasohen ofertat ekonomike eshte nje diference prej me shume se 15 milion leke. Kjo diference i rendon buxhetit te shtetit vetem e vetem qe te shpallet fitues nje operator ekonomik i cili ka falsifikuar pjesen me te madhe te dokumentacionit si dhe ka mungesa te theksuara kapacitetesh teknike dhe nuk ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar, pasi objekti i veprimtarise se tij nuk eshte sherbimi i lavanderise objekt i kesaj kontrate.

Per sa parashtruam me siper Autoriteti kontraktorne menyre demonstrative ka shkelur nje nga parimet baze te percaktuarane nenin 2 te Ligjit nr 9643, dt 20.11.2006 "Perprokurimin Publik", i ndryshuar, mosdiskriminim dhe trajtimi barabarte i ofertuesve ose kandidateve;

Ne respektim te plote te Ligjit per Prokurimin Publik dhe akteve te tjera ligjore per zbatimin e tij, kerkuam Autoritetit Kontraktor te verifikonte faktet e paraqitura nga ana jone si dhe te bente rivleresimin e procedures duke kualifikuar oferten e operatorit ekonomik DEVIS shpk si oferte e vlefshme dhe duke s'kualifikuar oferten e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik.

Autoriteti Kontraktor me date 06.02.2020 nepermjet postes elektronike me shkresen nr.444 prot date 06.02.2020 ka marre vendim qe te mos e pranoje ankesen e operatorit ekonomik DEVIS sh.p.k. pasi ankeses i mungonte baza ligjore.

Autoriteti Kontraktor ka detyrimin ligjor te kryej verifikimet e nevojshme te dokumentacionit per te cilin eshte njoftuar qe nuk eshte i rregullt dhe permban te dhena te falsifikuara me qellim kualifikimin e bashkimit te operatoreve ekonomik Alfa Cleaning dhe shoqerise KOMBI INVEST.

Minimalisht AK Spitali Rajonal Fier duhet te verifikonte ne administraten tatimore faturat te cilat edhe me sy te lire dallohen qe jane korrigjuar vlerat dhe sasite.

Eshte e dukshme qe autoriteti kontraktor me veprimet dhe mosveprimet e tij tregon qe po favorizon bashkimin e operatoreve ekonomik Alfa Cleaning dhe shoqerise KOMBI INVEST pavarsisht se kane mungesa te theksuara ne dokumentacion, ka paraqitur te dhena te rreme dhe dokumentacionjo te rregullt si dhe po shkakton dem ekonomik buxhetit te shtetit 15 milion leke. Sa me siper kerkojme pranimin e ankeses tone dhe kryerjen e verifikimeve te nevojshme nga ana juaj per te vertetuar paligjshmerite e kryera nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Fier.

II.5.3. Në datën 24.02.2020 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 187/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 581 prot., datë 20.02.2020, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Devis” sh.p.k se: *“Operatori ekonomik nuk ka paraqitur certifikaten e pronesisë se automjeteve ose kontraten e shitblerjes ose kontrate dhurimi ose cdo dokument tjetër me të cilin fitohet e drejta e pronesisë sipas Kodit Civil”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 3.3.4 e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesave si më poshte vijon:

Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 2 (dy) mjete transporti mallrash, me kapacitet transportues minimalisht 500 kg, me qëllim transportin e mallit, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës, si më poshtë:

f) Dokument që vërteton pronësinë ose qiramarrjen si më poshtë:

➤ *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*

- *Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.*

Ose

➤ *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*

- *Kontratë qiraje (noteriale)..*

g) *Leje qarkullimi e mjetit.*

h) *Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,*

- i) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,*
- j) Certifikate për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg).*

III.1.2. Nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të kriterit të mësipërm, ashtu siç edhe vetë operatori ekonomik ankimues pranon, nuk është paraqitur asnjë dokument certifikatë pronësie për mjetet e kërkuara. Nga ana e atij është hedhur në SPE dokumentacion për 3 mjete transporti mallrash, përkatësisht për mjetet me targë AA891 OH, AA076PN dhe TR3620U, për të cilat është paraqitur leje qarkullimi e mjetit, policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve dhe certifikatë e kontrollit teknik të tyre, në emër të shoqërisë “Devis” sh.p.k. Për të tre mjetet mungon certifikata e pronësisë së tyre ose kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

III.1.3. Lidhur me arsyen e skualifikimit, operatori ekonomik ankimues në ankesën e paraqitur pretendon se:

Shoqeria jone ka paraqitur dokumentacion per mjetet e kerkuara; Lejen e qarkullimit, Siguracion, Certifikaten e kontrollit teknik, gjithashtu keto mjete jane te pasqyruara ne bilancet e shoqerise si dhe ne ekstraktin e rregjistrimit ne QKB, pra eshte vertetuar qe keto mjete jane ne pronesi te shoqerise DEVIS shpk.

Qellimi i vendosjes se kriterit eshte qe nepermjet dokumentacionit te paraqitur operatori ekonomik te vertetoje se disponon mjetet e kerkuara te nevojshme per realizimin e kesaj kontrate. Eshte mese e qarte me dokumentacionin e paraqitur eshte plotesuar kriteri i percaktuar. Per autoritetin kontraktor eshte e rendesishme te provohet qe operatori ekonomik zoteron kapacitetet teknike ne lidhje me mjetet e transportit, ne perputhje dhe ne perpjesetim me natyren dhe volumin e kontrates objekt prokurimi, kapacitet i cili eshte vertetuar se disponohet nga operatori ekonornik "DEVIS" sh.p.k. Konkretisht ka paraqitur dokumentacion disponon ne pronesi tre mjete nga dy te kerkuara te vertetuara me Lejen e qarkullimit, Siguracion, Certifikaten e kontrollit teknik ku eshte percaktuar pronesia e tyre DEVIS sh.p,k, per tre mjete transporti duke e tejkeluar sasine e kerkuar, gjithashtu keto mjete jane te pasqyruara ne bilancet e shoqerise si dhe ne ekstraktin e rregjistrimit ne QKB, duke krijuar bindshem garanci per realizimin me sukses te kontrates.

Vendimi i KVO-se eshte absolutisht i padrejte dhe i bazuar ne pretendime hipotetike dhe jo ne fakte qe ekzistojne i cili na skualifikon pa asnje arsye, ne kundershitim te hapur me rregullat e prokurimit publik. Kompania DEVIS ka plotesuar ne menyre te perpikte te gjitha dokumentat tekniko-ligjore, sipas te gjitha kerkesave te pergjithshme dhe te vecanta te kualifikimit te kerkuara nga AK. Te ndodhur ne keto kushte ne sqarojme se me kete kuotim jo vetem qe po behet nje padrejtesi e hapur ndaj subjektit tone, por nga ana tjeter po i shkaktohet nje dem ekonomik relativisht i madh buxhetit te shtetit.

Cdo AK dhe cdo anetar i KVO, nese do te kishte vemendjen per te pare dokumentat e gjendura ne SPE te operatorit DEVIS sh.p.k dhe pikerisht ne QKB (bashkelidhur ketij materiali), sheh ne pronesi te rregjistruara te gjitha automjetet qe disponon kompania dhe konkretisht 3 prej te cilave ishin depozituar ne sistemin e prokurimeve elektronike.

1. Automjeti me targe AA8910H
2. Automjeti me targe AA076PN
3. Automjeti me targe TR 3620U

Ne ligjin Nr.8378, date 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nenin, 92 pika parashikohet:

Pjesa III Dokumentat e qarkullimit dhe regjistrimit

Neni 92 Formalitetet e nevojshme për qarkullimin e automjeteve, të motomjeteve dhe rimorkiove
1. Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një leje qarkullimi dhe të jenë të regjistruara prane degëve perkatese të Drejtorisë së Përgjithshme të Sherbimeve të Transportit Rrugor. 2. Deget e Drejtorisë së Përgjithshme të Sherbimeve të Transportit Rrugor marrin masa për regjistrimin dhe leshojnë lejen e qarkullimit ndaj atij që verteton se është pronar i mjetit, duke treguar, kur duhet, edhe gjeneralitetet e shfrytëzuesit ose të qiramarresit me të drejtë blerjeje ose të shitësit me marrëveshje me të drejtë rikthimi, kur nuk paguhen keestet, sic është treguar në nenin 90.

Pra si mund të pretendohet që mjete që ka leje qarkullimi është mjet pa pronësi kur pronësia është e shprehur në QKB por jo vetëm, por edhe në bilancet e dorëzuar në SPE ku pronësia e tyre sic edhe ju do ta shqyrtoni është në emrin e DEVIS shpk,

Ne kontrollin teknik të mjetit është shkruar qarte targa e makines dhe që leshohet leja e qarkullimit pikerisht sepse mjeti ka pronësi.

Ligji nr. 10 076, date 12.2.2009 për sigurimin e detyrueshem në sektorin e transportit, ndryshuar me ligji nr. 10455, date 21.7.2011, Neni 4, Detyrimi për t'u siguruar

1. Pronari i çdo mjeti transporti, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeti i transportit do të mbetet në qarkullim.

2. Kur mjeti i transportit është subjekt i detyrimit për t'u regjistruar apo licencuar dhe, sipas ligjit, duhet të ketë një certifikatë regjistrimi apo licencimi, autoritetet përgjegjëse mund të leshojnë certifikatën e regjistrimit ose ndonjë dokument tjetër, të barasvlershem me të, vetëm pasi pronari i mjetit të transportit provon me dokumente se e ka lidhur kontratën e sigurimit, sipas këtij ligji.

Pra si mund të kishte mjeti siguracionin pa pronësi?

Edhe në dokumentin e siguracionit ka një zë të vecantë ku shkruhet pronësia e mjetit si dhe NIPTI i shoqërisë, elemente që nuk lenë vend për dyshime apo me shume akoma .

Ne nenin 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 4, të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, përcaktohet se:

4. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbesisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen paprekur përmbajtjen e saj.

Shoqëria "Devis" sh.p.k me dokumentacionin e paraqitur verteton dukshem se disponon në pronësi automjetet e kerkuara nga autoriteti kontraktordhe si e tille duhet kualifikuar.

Persa me siper shkaku i s'kualifikimit tone nuk qendron, shpresojme ne reagimin e menjehershem nga ana juaj, ne te kundert, shoqeria DEVIS shpk do te ndjeke te gjitha shkallet e ankimimit ne institucionet e parashikuara nga ligji,

Bashkelidhur gjeni:

- 1. Ekstraktin e historikut leshuar nga QKB i shoqerise DEVIS sh.p.k,*
- 2. certifikatat e pronesis se automjeteve*
- 3. Lejet e qarkullimit te mjetieve.*
- 4. Certifikatat e kontrollit teknik te mjeteve rrugore,*
- 5. Policet per sigurimin e detyrueshem te mjeteve,*

Gjithashtu ankimuesi pohon se: "oferta jone eshte skualifikuar vetem per gabime njerezore te mosparaqitjes se certifikates se pronesis se mjetit por qe ky fakt vertetohej lehtesisht nga nje sere dokumentash te tjere ligjore si Leja e qarkullimit, Siguracion, certifikaten e kontrollit teknik, gjithashtu keto mjete jane te pasqyruara ne bilancet e shoqerise si dhe ne ekstraktin e rregjistrimit ne QKB, pra eshte vertetuar qe keto mjete jane ne pronesi te shoqerise Devis shpk

III.1.4. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues për shqyrtimin e ankesës së tij, argumenton:

Se pari, nga verifikimi ne sistemin elektronik te prokurimeve, por edhe ne dosjen e tenderit, konstatohet se ne oferten elektronike te paraqitur nga subjekti ofertues DEVIS shpk, per kete tender, mungon dokumentacioni perkates per plotesimin e kriterit per kualifikim te percaktuar ne shkronjen "a", e pikes 3.3.4, te shtojces 8, Kriteret e vecanta te kualifikimit, te DST. Pra, mungon fizikisht Certifikata e pronesis e leshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose Kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose cdo dokument tjeter me ane te te cilit fitohet e drejta e pronesis sipas Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

Bazuar tek ky fakt, jemi perpara kushteve qe ofertes se subjektit ofertues ne kete gare DEVIS shpk, i mungon dokumentacion per nje nga kriteret per kualifikim te percaktuara ne DST. Pra, subjekti ofertues ne kete gare DEVIS shpk nuk ka dorezuar nje dokument te percaktuar shprehimisht ne kerkesat per kualifikim te DST. Ne paragrafin e fundit te Shtojces 8, Kerkesat per Kualifikim, te DST, sanksionohet shprehimisht se: „Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim." Ne nenin 46, pika 1, te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedural e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevoishme, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohen dhe jodiskriminuese." Gjithashtu ne nenin 53, pika 3 te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet se: "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentat e tenderit ... ".Autoriteti Kontraktor, ne analizen dhe shqyrtimin qe i ben ankeses dhe pretendimeve te parashtruara ne ate, bazohet totalisht ne dispozitat e sipercituara ligjore, ne rregullat e prokurimit, ne kriteret apo kushtet e percaktuara ne DST, si dhe ne qendrimet ligjore dhe te konsoliduara qe ka mbajtur

Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), ne trajtimin qe kjo e fundit i ka bere ceshtjeve te ngjashme, ku jane shtjelluar dhe argumentuar analiza dhe vendimmarrja, qe ajo i ka bere pretendimeve te ngjashme, te paraqitura nga ankimues te ndryshem [...]. Mosplotesimi qofte edhe i nje kriteri te vendosur nga ana e autoritetit kontraktor, e ben oferten e operatorit ekonomik te pavlefshme, si dhe perben kusht per skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit, pra nga gara, sic percaktohet ne paragrafin e fundit te Shtojces 8, te DST. Per kete arsye, LPP dhe rregullat e prokurimit, nuk mund te lejojne kualifikimin e nje operatori ekonomik ne rast se ai ka mungese dokumentacioni sipas kritereteve percaktuara nga vete autoriteti kontraktor. Keto qendrimet te ligjit dhe te rregullave te prokurimit, sa i takon trajtimin te kesaj ceshtje, kane rendesine e tyre te madhe per zhvillimin e nje procedure konkurruese prokurimi, pasi ato jane garante te zhvillimit te nje gare te barabarte mes paleve (neni 2 i LPP-se). Qendrimet ndryshe nga cfare percaktojne Ligji dhe rregullat e prokurimit per kete pike, do te cenonin sigurine juridike te paleve pjesmarrese ne gare dhe do te legjitimonin diskriminimin midis garuesve. Cfare do te ndodhte nese cdo subjekt ofertues, nuk dorezonte ne sistemin elektronik te prokurimeve, dokumentat e kerkuara teper qarte ne DST dhe pastaj nepermjet ankimimit kerkon qe keto dokumenta ti dorezoje nepermjet ankeses, per te bere oferten nga te pavlefshme ne te vlefshme? Atehere, gara e zhvilluar ne oren dhe daten e caktuar ne sistemin elektronik te prokurimeve nuk do te kishte sens dhe do te humbiste kuptimin e saj. Pikerisht kjo eshte edhe arsyeja pse ligjveneresi nepermjet dispozitave te meiperme ligjore apo rregullave te prokurimit, ka garantuar cdo ofertues duke i dhene sigurine juridike te duhur, qe gara zhvillohet vetem ne oren dhe daten e caktuar per dorezimin dhe hapjen e ofertave, dhe jo pas saj. Pas mbarimit te ketij afati asnje pjesmarres ne gare nuk kate drejte per asnje lloj arsyeje apo justifikimi te fus dokumenta ne oferten e tij per ta kthyer ate nga te pavlefshme ne te vlefshme (fjalialia e dyte e pikes 1 te nenit 53 te LPP-se). Nga shqyrtimi dhe nga analiza e kesaj ankese, ne fakt, nga subjekti ankimues kerkohet ne thelb pikerisht kjo gje. Ne ankese pranohet edhe nga vet subjekti ankimues qe ky dokument mungon, pasi nuk eshte ne listen e dokumentave te dorezuar ne sistem per plotesimin e ketij kriteri (sic jane leja e qarkullimit, etj.). Gjithashtu, fakti i mungeses se ketij dokumenti verifikohet nga keqyrja ne SPE e ofertes se paraqitur nga ky subjekt. Por, megjithate nga subjekti ankimues kerkohet nepermjet ankeses, qe ky dokument te merret ne konsiderate, duke ia bashkengjitur ankeses. Autoriteti Kontraktor sqaron se ne rast se operatori ekonomik ankimues do te kishte pretendime ne lidhje me kerkesen e mesiperme te autoritetit kontraktor, ka pasur ne dispozicion momentin procedural te paraqitjes se ankeses mbi hartimin e dokumenteve dhe kritereteve te vecanta te kualifikimit te procedures se prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP ose momentin procedural te paraqitjes se kerkeses per sqarime prane autoritetit kontraktor deri ne pese dite para dorezimit te ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-se. Nga verifikimi i dosjes se tenderit nuk rezulton te kete pasur kerkesen ankimore apo kerkesen per sqarime ne lidhje me shkronjen "a", te pikes 3.3.4, te shtojces 8, Kriteret e vecanta te kualifikimit, te DST, se kesaj procedure prokurimi. Ne keto kushte, subjekti ankimues, si cdo subjekt tjeter ofertues qe ka qene i interesuar per te marr pjese ne kete gare, duke qene se e ka pranuar kete kusht apo kriter kualifikimi ka qene i detyruar te dorezoje ne sistemin elektronik te ketij tenderi, dokumentacionin sipas shkronjes "a", te pikes 3.3.4, te shtojces 8, Kriteret e vecanta te kualifikimit, te DST. Per me teper qe,

ky kriter kualifikues qendron si pike me vete ne Shtojcen 8 te DST (shkronja "a", e pikes 3.3.4), i pasuar nga kriteret e tjera te kualifikimi, te renditura ne shkronjat: ,b', ,c', ,d' ,e', te pikes 3.3.4.Rrjedhimisht, per sa me siper, pretendimi i subjektit ankimues nuk qendron, pasi nuk gjen mbeshetje ne ligjin nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar [...]. Ne ankesen e tij, subjekti ankimues parashton se ne dokumentin ekstrakt i QKB te DEVIS shpk, te gjendura ne SPE, jane te shenuara te gjitha automjetet qe disponon kompania, duke cituar 3 (tre) prej tyre, dokumentacioni i se cilave eshte depozituar ne sistemin e prokurimeve elektronike (pervec certifikates se pronesise).

Nga verifikimi i dokumentacionit te subjektit DEVIS shpk, te depozituar ne tender, konstatohet se ne ekstraktin e QKB-se (te thjeshte e historik), ne piken 13 te tij "vende te tjera te ushtrimit te aktivitetit", rezultojne te cituara adresat dytesore te ushtrimit te aktivitetit Tirane, markat e mjeteve dhe targat e tyre. Ne kuptimin e ligjit per QKB, te Kodit Civil, te Kodit Rrugor apo cdo akti tjeter ligjor dhe nenligjor, shenimet e adresave dytesore te ushtrimit te aktivitetit te nje subjekti, nuk perbejne detyrimisht fakt apo tregues se ato jane ne pronesi te subjektit, sepse ato mund te jene te marra me qera apo ne huaperdorje apo ne formate tjera qe njeh ligji. Ne praktike, sic mund te konstatohet lehtesisht ne ekstraktin e QKB te shume subjekteve, ne piken 13 te tij "vende te tjera te ushtrimit te aktivitetit", vendosen adresat dytesore (NIPT sekondare) te ushtrimit te veprimtarise se subjektit, te cilat mund te jene mjete, por mund te jene edhe zyra, godina, kapanone, prone e paluajtshem ne pergjithesi, etj., ne pronesi te subjektit, por edhe te marra me qira apo huaperdorje.

Kete pohim e vertetojne edhe seksionet perkatese ne ekstraktin historik, ku evidentohen hapjet e adresave dytesore, dhe ku konkretisht thuhet p.sh: "eshte shtuar adresa Tirane, Tirane Fiat Doblo me large AA 8910H" pa specifikuar nese eshte ne pronesi apo eshte marr me qira.

Pra, eshte e qarte, se gjithsesi, thjesht fakti qe mjetet jane te cituara ne ekstraktin e QKB, nuk perbejne argument ligjor qe mjetet jane ne pronesi. Jo me kot, dhe me te drejte AK ne Shtojcen 8 te DST, ka kerkuar, certifikaten e pronesise se mjetit, si dokumentin e vetem dhe ligjor i cili tregon dhe verteton pronesine e nje mjete ne Republiken e Shqiperise ose kontraten e qirase, ne rast se mjetet do te ishin marre me qira.

Per kete arsye, bazuar ne parimin e analogjise juridike, sjellim ne vemendje edhe faktin se kjo eshte arsyeja pse ne rastet e shit-blerjes se nje automjeti te regjistruar rregullisht ne Republiken e Shqiperise, noteri per te kryer aktin e kalimit te pronesise (kontraten e shitblerjes), nuk kerkon as ekstraktin e QKB, as lejen e qarkullimit, as bilancin e subjektit dhe as siguracionin e mjetit, por kerkon paraqitjen e certifikates se pronesise se mjetit. Ky fakt eshte nje tregues dhe prove teper domethenese juridike, qe tregon rendesine e ketij dokumenti dhe arsyet ligjore per te cilat AK me te drejte e ka kerkuar ne DST, se bashku me dokumentat e tjera te mjetit, te cilat kane efekt dokumentues per rregullshmerine e levizjes (qarkullimit) te mjetit ne rruge dhe jo per pronesine e tij.

Kerkesat e AK te percaktuara ne DT jane ne perputhje me dispozitat e Kodit Rrugor, duke kerkuar te gjitha dokumentacionin ligjor qe kane te bejne me pronesine e mjetit ose qiramarrjen e tij sipas rastit, te shoqeruara edhe me dokumentat e tjera te percaktuara ne shkronjat b', ,c', ,d' dhe ,e',

te pikes 3.3.4 te Shtojces 8, te cilat kane efekt dokumentues per rregullshmerine e levizjes (qarkullimit) te mjetit ne rruge, si leje qarkullimi, siguracion, akt i kontrollit teknik.

Lidhur me referimin qe subjekti ankimes ben ne ankese se "pronesia (e mjeteve) eshte e shprehur edhe ne bilancet e dorezuara ne SPE ... ", ky pretendim pasi u verifikua ne dosjen e tenderit, nuk rezulton i vertete. Pra, pasi u keqyren bilancet e Devis shpk, rezulton se ne seksionin pasqyra e pozicionit financiar (bilanci), tek aktivet materiale nuk ka asnje te dhene ne lidhje me identifikimin e mjeteve te prezantuara ne tender nga subjekti apo nje listim i tyre qe tregon pronesine, pervec se vlerave te ketyre aktiveve (pra, vetem shifra).

Lidhur me referimin tek Ligji nr.10076 date 12.2.2009 "Per sigurimin e detyrueshem ne fushen e transportit" i ndryshuar, te cilin subjekti ankimes e perdor per te provuar ne menyre te terthorte pretendimet e tij, ky i fundit ka cituar nenin 4 te ketij Ligji, ku thuhet:

"Neni 4

Detyrimi per t'u siguruar

1. Pronari i cdo mjeti transporti, perpara perdorimit te mjetit, eshte i detyruar te lidhe nje kontrate sigurimi, sipas pikes 1 te nenit 2 te ketij ligji, si dhe te siguroje rinovimin e saj per aq kohe sa mjeti i transportit do te mbetet ne qarkullim.

2. Kur mjeti i transportit eshte subjekt i detyrimit per t'u regjistruar apo licencuar dhe sipas ligjit duhet te kete nje certifikate apo licencimi, autoritetet pergjegjese mund ta leshojne certifikaten e regjistrimit ose ndonje dokument tjeter, te barasvlershem me te, vetem pasi pronari i mjetit te transportit provon me dokumente se e ka kontraten e sigurimit, sipas ketij ligji.

Subjekti ankimes ka cituar nenin 4 te Ligji nr.10076 date 12.2.2009, por ai nuk ka pasur ne vemendjen e tij percaktimet e nenit 2 te ketij Ligji, te cilat sqarojne se:

"Neni 2

Fusha e veprimit

1. Sigurimi i detyrueshem ne sektorin e transportit perfshin:

a) sigurimin e pasagjereve nga aksidentet ne transportin publik;

b) sigurimin e pergjegjesise se pronarit ose te perdoruesit te mjetit motorik, qe me poshte do te referohet si sigurimi i pronarit, per demet shkaktuar paleve te treta nga perdorimi i ketij mjeti

Pra shprehja 'pronar' ne piken 1 te nenit 4, sqarohet ne shkronjen 'b' te pikes 1, te nenit 2 te Ligjit.

Gjithashtu ne nenin 3 te ketij Ligji, "Perkufizime", sqarohet shprehimisht se perdoruesi i mjetit, pra ai qe per efekt te qarkullimit te mjetit ne rruge, pajiset me dokumentacionin e kerkuar nga ligji, si siguracioni, akti i kontrollit teknik, leja e qarkullimit, etj., mund te jete pronari i mjetit, por mund te jete edhe perdoruesi i mjetit, i cili sic thote ligji "perdor mjetin e transportit me miratimin e pronarit".

"Neni 3

Perkufizime

Ne kete ligj termat e meposhtem kane keto kuptime:

1. "Aksident" eshte ngjarja, ku rezulton dem nga perdorimi i mjetit te transportit.

2. "Mjet transporti" eshte mjeti motorik, avioni dhe mjeti lundruar.

3. "Mjet motorik" është mjete që leviz në tokë, por jo mbi shina, me anë të fuqisë motorike, pavarësisht nga numri i rrotave. Mjet motorik është edhe rimorkioja dhe gjysmerimorkioja, të bashkuara ose jo me mjetin motorik tërheqës.

4. Përdorues i një mjeti transporti" është një person fizik apo juridik, që përdor mjetin e transportit me miratimin e pronarit.

5. "Drejtuës" është personi që drejton mjetin e transportit.

Pra është e evidente se ligji ben një ndarje të qartë midis pronarit të mjetit dhe përdoruesit të mjetit i cili e përdor atë me miratimin e pronarit, por që, që të dy pajisen me policen e sigurimit të detyrueshëm të mjetit.

Pavarësisht sqarimeve të mesiperme, sic e kemi sqaruar edhe me siper, zyrtari i ngarkuar me shqyrtimin e ankesës, analizën dhe shqyrtimin që i ben ankesës dhe pretendimeve të saj, si dhe vendimin për refuzimin e saj, e bazon ngushtesisht në dispozitat e Ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, në rregullat e prokurimit publik, në kriteret apo kushtet e përcaktuara në DST, në qendrimet ligjore dhe të konsoliduara që ka mbajtur Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), si dhe në parimin ligjor prokurues që cdo operator ekonomik pjesëmarrës në një garë prokurimi, duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar për cdo kriter të vendosur në kërkesat për kualifikim, për sa kohë që nuk e ka kontestuar atë kriter.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes dhe rrethanave të saj, Autoriteti Kontraktor me shqyrtimin e ankesës, pasi analizoi me kujdes pretendimet e ankimesit të parashtruara në ankese, provat shkresore të paraqitura, pasi verifikoi dokumentacionin e ofertës së Devis shpk, të shkarkuar nga sistemi elektronik i prokurimeve (SPE), si dhe nga informacioni i teresise së dosjes së këtij tenderi, pasi u konsultua me dispozitat e Ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, gjykon se pretendimet e subjektit ankimes nuk qendrojnë, pasi nuk gjejne mbështetje në ligjin nr.9643 date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, dhe në këte kushte kjo ankese nuk pranohet."

III.1.5. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik ankimes nuk është depozituar në sistemin e prokurimeve elektronike asnjë dokumentacion që të vërtetojë të drejtën e pronësisë në lidhje me mjetet e paraqitura. KPP sqaron se, kriteri për aktin e pronësisë së mjeteve është i përcaktuar qartësisht në dokumentat e tenderit, kriter ky që nuk është ankimuar nga ana e operatorit ekonomik ankimes në momentin e publikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi. Nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit është përcaktuar kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit që vërteton pronësinë e mjeteve të cilat janë: *Certifikata e pronësisë ose kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë* si edhe leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve etj. Dokumenti leje qarkullimi nuk është i barazvlefshëm me dokumentin e aktit të pronësisë – certifikatën e pronësisë, e cila kjo e fundit vërteton disponimin e mjetit nga një pronar, ndërsa leja e qarkullimit lidhet me faktin e targimit të mjetit që do të qarkullojë. Sqarojmë se akti i pronësisë së një mjeti vërtetohet nëpërmjet certifikatës së pronësisë, në të cilën jepen të gjitha të dhënat për poseduesin e mjetit.

III.1.6. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

III.1.7. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.8. Në VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28 “Kontratat e Shërbimeve”, pika 5, përcaktohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon:*

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.1.9. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Gjithashtu edhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, parashikon se, në plotësim të kriterëve të veçanta të kualifikimit, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të deklarojnë mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, KPP konstaton se, ndër të tjera autoriteti kontraktor ka parashikuar mjete të cilat janë të nevojshme për realizimin e synimit parësor të autoritetit kontraktor, të përmbushjes me sukses të kontratës objekt prokurimi, për të cilat janë kërkuar dhe një sërë dokumentash për të vërtetuar disponimin e tyre (në pronësi ose me qera). Në lidhje me këto mjete, KPP konstaton se, ankimuesi nuk ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar për mjetet e nevojshme për këtë shërbim.

Ndërkohë, bashkangjitur ankesës së drejtuar autoritetit kontraktor më datë 22.01.2020, si dhe ankesës së paraqitur pranë KPP-së më datë 03.02.2020, operatori ekonomik “Devis” sh.p.k, ka përcjellë (ndër të tjera) edhe kopjet e certifikatave të pronësisë për automjetet e paraqitura në ofertë.

Lidhur me sa më sipër, KPP gjen me rast të sqarojë se operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Paraqitja pranë autoriteteve kontraktore, apo pranë KPP-së, e dokumentacionit të kërkuar në DT, pas hapjes së ofertave, është i pavlefshëm, me përjashtim të rastit kur kemi të bëjmë me sqarime të cilat kërkojnë nga vetë autoriteti kontraktor në mbështetje të nenit 53, pika 1 të LPP. Në rastin konkret, nuk ndodhemi në këto kushte dhe autoriteti kontraktor me të drejtë nuk ka kërkuar sqarime, por e ka konsideruar dokumentacionin e paraqitur nga ana e ankimuesit në tender të parregullt, pasi ai (dokumentacioni mbi automjetet), nuk paraqet paqartësi që duhen sqaruar, por paraqet mangësi në përmbajtje (mbështetur në interpretimin ligjor të dhënë si më sipër) dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

Përsa më sipër, në kushtet kur edhe nga vetë operatori ekonomik ankimues pranon faktin e mosdorëzimit të dokumentacionit në lidhje me aktin e pronësisë – certifikatën e pronësisë për mjetet e kërkuara në dokumentat e tenderit, KPP gjykon se operatori ekonomik nuk ka përmbushur kriterin për këtë pikë.

III.1.11. K.P.P. gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e mësipërme të autoritetit kontraktor në lidhje dokumentat e tenderit, specifikimet teknike etj., publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, për shërbimin objekt i procedurës së prokurimit, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës, parashikuar

nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësisht të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave të mësipërme, ai gjithashtu ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”*.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm e, rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Devis” sh.p.k për BOE “Alfa Cleaning” sh.p.k & “Kombi Invest” sh.p.k dhe për zhvillimin e procedurës së prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

III.2.1.Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”*

III.2.2.Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të argumentojë se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP nuk mund të pranohet. Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që operatori ekonomik ankimues, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në

ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesmarrës në procedurën e prokurimit, apo lidhur me zhvillimin e procedurës së prokurimit do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm i drejtpërdrejtë nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Për këtë arsye, këto pretendime nuk do të mërren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mospranojë ankesat e paraqitura nga operatori ekonomik “Devis” sh.p.k, për procedurën e prokurimit me Nr. REF-44572-11-22-2019, me objekt: “*Sherbimi i Lavanterise dhe Hotelerise ne Spitalin Rajonal Fier*”, me fond limit 162 155 700 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 06.01.2020, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Fier.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 137 Protokolli

Datë 03.02.2020

Nr. 187 Protokolli

Datë 14.02.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Wilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha